RAPORT VLERËSIMI

SITUATA AKTUALE, SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE EFEKTIVE NË NIVELIN E VETËQEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Shkurt 2018

Funded by the European Union
Suedi Sverige
AGENZIA ITALIANA PER LA COOPERAZIONE ALLO SVILUPPO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Schweizerische Eidgenossensch
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC
USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE
UNDP Empowered lives. Resilient nations.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2014 ka shënuar një kthesë të rëndësishme për Shqipërinë përsa i përket hartimit dhe miratimit të kuadrit ligjor mbi qeverisjen e mirë në nivel vendor. Një gjë e tillë ka nxitur zhvillime pozitive në informimin e publikut, transparencën, llogaridhënien si dhe në vendimmarrjen me pjesëmarrje në nivelin e njësive të qeverisjes vendore në vendin tonë. Megjithatë, pavarësisht zhvillimeve në fushën e transparencës dhe llogaridhënies zbatimi efektiv i kuadrit përkatës ligjor kryesisht në nivelin vendor ende përbën një sfidë.

Aktorë të ndryshëm janë përpjekur të vlerësojnë dhe masin nivelin e transparencës në nivel vendor si një mënyrë vlerësimi të cilësisë së qeverisjes, besimit në qeverisje etj. Pavarësisht këtyre studimeve të cilat kanë kontribuar në diskursin publik të transparencës në nivel vendor, nuk ka një studim vlerësimi të plotë mbi situatën aktuale, nivelin e zbatimit të programit të transparencës, sfidave, vështirësive dhe mundësive që ekzistojnë për transparencë efektive dhe llogaridhënie në nivelin lokal. Për më tepër, ende nuk ka një sistem të unifikuar dhe të standartizuar për matjen e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit vendor. Bashkitë në rolin e autoriteteve publike kanë detyrimin për të vënë në zbatim Programin e Transparencës si intrumentin kryesor për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin vendor. Por ky Program nuk është i shoqëruar me një sistem indikatorësh që mat zbatimin e tij. Krijimi i një sistemi matës i Programit të Transparencës mbetet gjithashtu një çështje kritike për monitorimin dhe raportimin e vazhdueshëm të nivelit të transparencës në çdo bashki, si edhe për të bërë më pas edhe krahasimin ndërvendor të nivelit të dy parimeve - transparencës dhe llogaridhënies.

Vlerësimi i situatës aktuale mbi transparencën dhe llogaridhënien në nivelin e qeverisjes vendore bëhet në dritën e përpjekjeve të projektit "Konsolidimi i Reformës Administrative dhe Territoriale – STAR 2" nëpërmjet mbështetjes për zbatimin e legjislacionit mbi të drejtën e informimit dhe konsultimit publik. Si i tillë ky studim synon të evidentojë sfidat, vështirësitë dhe pengesat për sigurimin e transparencës efektive në nivel vendor si dhe praktikat e mira dhe faktorët që kushtëzojnë suksesin. Qëllimi final i studimit është që të shërbejë si bazë për të hartuar një model standard të Programit të Transparencës për t'u zbatuar në nivelin e qeverisjes vendore të përshtatur me specifikat e këtij niveli, për të vënë në dispozicion të publikut informacion me interes publik në kohë dhe në mënyrë efikase.

Vlerësimi bën matjen e parimeve të transparencës dhe llogaridhënies nëpërmjet pesë fushave të vlerësimit të cilat detajohen në 20 tregues.

Metodologjia e vlerësimit kombinon shqyrtimin e dokumentacionit, analizën krahasimore, intervista, fokus grupe dhe analizë multivariate (me kërkimin cilësor dhe sasior). Puna kërkimore është realizuar gjatë muajve shkurt-mars 2018. Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat e këtij vlerësimi janë siguruar nga burimet e mëposhtme:

- Analizimi i kornizës relevante ligjore në lidhje me transparencën në nivelin e qeverisjes lokale;

- Kërkimi në internet në faqet zyrtare të 49 bashkive (bashki që kanë faqe interneti) rreth treguesve të infrastrukturës rregullatore të transparencës
- Analiza përmbajtësore e Programeve të Transparencës për 15 bashki të përzgjedhura;
- 3 diskutime në fokus grupe me përfaqësues të ekzekutivit, këshillit bashkiak dhe administratës së 15 bashkive të përzgjedhura;
- 18 intervista individuale me përfaqësues të ekzekutivit, këshillit bashkiak dhe administratës së 15 bashkive të përzgjedhura;
- 3 dialogë me aktorë të shoqërisë civile, medias dhe biznesit në tre bashki.
- Pyetësorë të administruar elektronikisht me Koordinatorët e të Drejtës për Informim (niveli i reagimit është 92%)

Rezultatet e para të kërkimit lidhen me identifikimin e detyrimeve ligjore të bashkive sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit (2014) si dhe ligjit të konsultimit dhe njoftimit publik (2015). Renditja e bashkive përsa i përket nivele tw performancës në lidhje me transparencën është kryer për 29 bashki të cilat kanë Program Transparence. Ndërkaq, rezultate të thelluara në lidhje me nivelin e zbatimit të programit të transparencës në nivel vendor, si dhe evidentimi i sfidave, faktorëve nxitës dhe frenues të sigurimit të transparencës etj është realizuar për 15 bashki të përzgjedhura.

Transparenca dhe llogaridhënia në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri

Gjetje të përgjithshme

Përgjithësisht, bashkitë e vendit kanë adoptuar infrastrukturën parësore që mundëson informimin publik dhe transparencën. Faqja e internetit është instrumenti më i pranishëm në pjesën më të madhe të bashkive (79%); ndërsa Programi i Transparencës (PT) dhe Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve (RKP), që janë instrumente të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe për rrjedhojë duhet të jenë në të njëjtat nivele, kanë një disbalancë të vogël. 48% e bashkive kanë bërë publik PT-në ndërsa 39% e tyre RKP-në.

Figura 1: Instrumentet për informim dhe transparencë në nivel vendor



Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak (VKB) janë nga treguesit e vendim-marrjes vendore ku bashkitë performojnë më mirë: 54% e bashkive i publikojnë në mënyrë të plotë VKB-të; dhe 13% e tyre mund të përmirësojnë publikimin e tyre. Ndërkaq, këshillimi me publikun nuk ndjek performancën e publikimit të VKB-ve, pasi vetëm 18% e bashkive publikojnë njoftimet për konsultime. Duket qartë se elementi ku bashkitë performojnë më dobët është publikimi i kuadrit i brendshëm rregullator, ku më problematike është rregullorja e këshillit bashkiak. Pjesa më e madhe e bashkive, 70%, nuk kanë të publikuar rregulloret e këshillit bashkiak. Ndërsa publikimi i rregullores së brendshme të funksionimit të administratës së bashkisë paraqitet si problem për më shumë se gjysmën (54%) e bashkive. Ndërsa përsa i përket kuadrit rregullator kombëtar bashkitë performojnë më mirë, duke qenë se 46% e bashkive publikojnë ligje, kode dhe konventat e ratifikuara nga vendi ynë.

Figura 2: Vlerësimi i kuadrit rregullator dhe vendimmarrjes vendore



Në lidhje me strukturat për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore, elementi ku bashkitë performojnë më mirë ka të bëjë me strukturën organizative të institucionit të bashkisë. Më shumë se gjysma e bashkive (52%) e kanë publikuar informacionin në lidhje me këtë element në mënyrë të plotë. Edhe informacioni për Koordinatorin për të drejtën e informimit (këtej e tutje Koordinatori i informimit) është bërë publik nga afro gjysma e bashkive (49%). Strukturat ku bashkitë kanë dështuar t'i vënë në zbatim janë me Koordinatori i njoftimeve dhe të konsultimit publik (këtej e tutje Koordinatori i Konsultimit) ku vetëm një pjesë e vogël, 7% e bashkive, kanë bërë publik kontaktet e Koordinatorit. Sistemi i administrimit të performancës së shërbimeve ende mbetet një tregues i pa vënë në zbatim nga asnjë bashki.

Figura 3: Vlerësimi i strukturave vendore për sigurimin e transparecës dhe llogaridhënies në nivelin e vetëqeverisjes vendore



Figura nr.4 tregon qartë se taksat dhe tarifat përfaqësojnë treguesin në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit vendor ku bashkitë kanë performancë të mirë. Më shumë se gjysma e bashkive, 56%, publikojnë informacion në lidhje me këtë katergori informacioni. Në lidhje me buxhetin vjetor vetëm 33% e bashkive publikojnë informacion ndërsa në lidhje me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA)-në vetëm 23% e tyre. Në të njëjtat nivele të ulëta është edhe transparenca në lidhje me nivelet e pagave të e administratës. Duket qartë se kontratat me të tretë mbeten elementi ku performohet dobët, vetëm 5% e bashkive publikojnë informacion.

Figura 4: Vlerësimi i transparencës së treguesve në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit vendor



Publikimi i të dhënave për funksionarët, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë përfaqëson një fushë problematike. Rreth 84% e bashkive (51) nuk publikojnë informacion dhe nuk kanë asnjë tregues në lidhje me këtë fushë. Vetën 1 bashki (2%) ka publikuar në faqen zyrtare informacion, ndërsa 9 bashki kanë publikuar informacion të pjesshëm..

Gjetje të veçanta

- Matja e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies nëpërmjet një kuadri vlerësues të përbërë prej 5 fushash vlerësimi dhe më tej e detajuar në 20 tregues, tregon se ende bashkitë e vendit nuk përmbushin kriteret e transparencës dhe llogaridhënies, të cilat përbëjnë detyrime ligjore për të drejtën e informimit;

- Përgjithësisht, bashkitë kanë marrë dhe vënë në zbatim në mënyrë formale modelin e Programin e Transparencës të miratuar Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nuk u arrit të identifikohej ndonjë bashki që të ketë zhvilluar dhe përshtatur PT-në me misionin dhe me fushën e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore dhe me specifikat e bashkisë përkatëse;

- Nga studimi identifikohen trendet kryesore në publikimin e informacionit zyrtar nga ana e bashkive, të cilat kryesisht publikojnë kategori 'të lehta' informacioni – të cilat nuk lidhen me mekanizmat e llogaridhënies (raporte auditi, prokurimet dhe kontratat, të dhëna për zyrtarët e lartë). Gjithsesi, identifikohen edhe bashki që krijojnë një model apo praktikë të mirë në lidhje me bërjen publike të një kategorie të caktuar informacioni;

- Kufizimet e vendosura nga ligji për të drejtën e informimit në lidhje me publikimin e informacionit publik për arsye të mbrojtjes së të dhënave personale, cënimit të sigurisë kombëtare etj, përdoren si justifikime nga ana e bashkive për mos publikimin e informacionit për arsye të mospërputhshmërisë me kërkesat ligjore;
- Në lidhje me informacionin e publikuar nga bashkitë, pak vëmendje i kushtohet karakteristikave tëtij si psh: nëse është i plotë duke përfshirë të gjitha dokumentet që parashikon ligji, apo lehtësisht i aksesueshëm, i përditësuar, i kuptueshëm, lehtësisht i përdorshëm etj. Nëse nuk merret në konsideratë ky aspekt, një situatë e tillë krijon një perceptim të gabuar të publikut në lidhje me transparencën. Pavarësisht se, vënia në dizpozicion e informacionit publik krijon perceptim pozitiv në lidhje me transparencën e njësive vendore, në realitet informacioni mund të i jetë i paplotë, i pakuptueshëm, i ngarkuar me terminiologji buroktratike, apo i papërditësuar dhe i publikuar në formate jo të aksesueshme;

- Edhe pse garantimi i transparencës është një detyrim ligjor, veçanërisht për shtresat më të varfra të komunitetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore duket se ende janë larg përmbushjes së detyrimit. Pavarësisht zhvillimeve pozitive në informimin nga ana e bashkive (OSSH-të, faqes zyrtare të internetit, rrjeteve sociale etj.), ende bashkitë nuk kanë zhvilluar kanale komunikimi dhe informimi specifike që adresojnë informimin publik të grupeve të cënueshme të shoqërisë si: banorë të varfër, të zonave të largëta, të pashkolluar, grupeve minoritare etj. Këto grupe kanë nevojë për qasje më të specializuar në informimin e tyre si një mënyrë për të siguruar aksesin e tyre në informacionin publik;

- Studimi tregon se bashkitë ndeshen përballë një sërë sfidash në përmbushjen e detyrimeve ligjore për të drejtën e informimit. Sfidat e identifikuara janë të ndryshme,

por kryesisht lidhen me burime të kufizuara njerëzore, kapacitete të limituara, kualifikime dhe trajnime të pakta, mungesën e një modeli specifik të programit të transparencës, mendësi tradicionale për kryerjen e detyrimeve nga ana e bashkive, njohuri të kufizuara në lidhje me të drejtën e informimit si nga administrata publike ashtu dhe nga ana e qytetarëve, presion i ulët nga qytetarët për informim, etj;

- Faktor për sukses në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor është edhe qasja institucionale ndaj të drejtës së informimit përkundrejt qasjes individuale – ku e drejta për informim fillon e mbaron me Koordinatorin e Informimit. Qasja institucionale në informim publik fillon me angazhimin e organeve dhe titullarëve për të qenë transparentë për veprimtarinë e institucionit që ata përfaqësojnë. Një angazhim i tillë reflektohet në krijimin e kuadrit të brendshëm rregullator, i cili qartëson proceset, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të ndryshme si dhe siguron llogaridhënie të qartë horizontale dhe vertikale në institucion. Gjithashtu, dedikimi i burimeve të duhura njerëzore dhe materiale për informimin publik u identifikua si faktor nxitës për transparencë të institucionit;

- Ende nuk ekziston një indeks i pjesëmarrjes qytetare në nivel vendor për të vlerësuar gjendjen e demokracisë vendore. Një mjet i tillë, nga njëra anë do të vendoste bashkitë në 'garë' me njëra-tjetrën për performancën më të mirë në lidhje me transparencën dhe, nga ana tjetër, do të nxiste aktorët e tjerë, sektorin jo-publik dhe qytetarët aktivë, në monitorimin e bashkisë së tyre për të vlerësuar gjendjen e demokracisë vendore në tërësi dhe të transparencës dhe llogaridhënies në veçanti.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 2
Transparenca dhe llogaridhënia në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri 3
Gjetje të përgjithshme 3
Gjetje të veçanta 6
HYRJE 12
1.1 Kuadri analitik për vlerësimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor 15
1.2 Metodologjia e vlerësimit 17
1.2.1 Shqyrtimi i Dokumentacionit 18
1.2.2 Diskutime në Fokus-Grupe 18
1.2.3 Intervista të thelluara individuale 19
1.2.4 Dialogë me komunitetin 19
1.2.5 Pyetësor i strukturuar i administruar elektronikisht 19
1.3 Qasja ndaj rezultateve 19
1.4 Profili i të intervistuarve 24
Kapitulli 2. Gjetjet 25
2.1 Legjislacioni mbi tranparencën dhe llogaridhënien në në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri 25
2.2 Identifikimi i detyrimeve ligjore dhe organi përgjegjës 28
2.3 Renditja e bashkive sipas nivele të performancës në lidhje me transparencën 32
2.4 Gjetjet analitike 33
2.4.1 Hartimi, miratimi, publikimi, zbatimi dhe monitorimi i programit të transparencës 33
2.4.2 Transparenca dhe Përgjegjshmëria financiare 36
2.4.3 Transparenca dhe përgjegjshmëria mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë 39
2.4.4 Transparenca mbi kuadrin ligjor, politik dhe vendimmarrja vendore 40
2.4.5 Transparenca dhe përgjegjshmëria mbi ushtrimin e funksioneve dhe të administrimit të shërbimeve 43
2.4.6 Transparenca në informimin publik me kërkesë 44
2.4.7 Kapacitetet vendore për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor 48
Profili i Koordinatorëve për të drejtën e informimit 48
Kualifikimet, njohuritë dhe aftësitë e Koordinatorëve të Informimit 49

Njohuritë dhe aftësitë e bashkive për zbatimin e kuadrit ligjor 49
Nevoja për ndërtimin e kapaciteteve 50
2.4.8 Sfidat dhe vështirësitë për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor 51
Vështirësia e publikimit të informacionit publik pa kërkesë në faqen zyrtare të internetit të bashkisë 51
Sfidat për zbatimin e të drejtës së informimit nga Koordinatorët e Informimit 52
2.4.9 Faktorët kyç për sukses në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor 53
Kapitulli 3. KONKLUZIONE 54
ANEKSE 57
Aneks 1: Kriteret në përzgjedhjen e bashkive 57
Aneks 2: Diskutimi në Fokus grup 60
Aneks 3: Dialogë me komunitetin 65
Aneks 4: Pyetësori dhe tabelat e përgjigjeve 67
Aneks 5: Kuadri analitik i vlerësimit 73
Aneks 6: Pikëzimi i bashkive sipas treguesve të vlerësimit 74
Aneks 7: Takimet në terren – Focus grupet dhe Dialogë me Komunitetin 76
Aneks 8: Pjesëmarrja në Focus Grupe dhe Dialogët e Komunitetit 78

Figura 1: Instrumentet për informim dhe transparencë në nivel vendor 3
Figura 2: Vlerësimi i kuadrit rregullator dhe vendimmarrjes vendore 4
Figura 3: Vlerësimi i strukturave vendore për sigurimin e transparecës dhe llogaridhënies në nivelin e vetëqeverisjes vendore 4
Figura 4: Vlerësimi i transparencës së treguesve në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit vendor 5
Figura 5: Përgjegjshmëria horizontale dhe ajo vertikale në nivelin e vetëqeverisjes vendore 13
Figura 6: Fushat kryesore të vlerësimit dhe treguesit përkatës 15
Figura 7: Diagrama e procesit zbatues të vlerësimit 16
Figura 8: Procesi i vlerësimit të treguesve 20
Figura 9: Diagrama e vlerësimit të performancës së bashkive në lidhje me informimin publik dhe transparencën 21
Figura 10: Ilustrimi i vlerësimit të treguesve për transparencën dhe llogaridhën në nivel vendor 22
Figura 11: Pjesëmarrësit e intervistuar sipas sektorëve dhe niveleve të përfaqësimit 24
Figura 12: Pjesëmarrësit e intervistuar sipas gjinisë 24
Figura 13: Fazat kryesore të Programit të Transparencës në nivelin e vetëqeverisjes vendore 26
Figura 14: Lista e Kontrollit mbi detyrimet ligjore të vetqeversisjes vendore për transparencë dhe llogaridhënie 28
Figura 15: Grupimet e bashkive sipas nivele të performancës në zbatimin e programit të transparencës 32
Figura 16:Grupimet e bashkive sipas nivele të performancës në zbatimin e programit të transparencës 32
Figura 17: Opinionet rreth këshillimit me publikun në nivelin e vetëqeverisjes vendore nga perspektiva e aktorëve jo-publik dhe publik 43
Figura 18: Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të Koordinatorëve për zbatimin e LDI 49
Figura 19:Vlerësimi i nivelit të njohurive dhe aftësitë e bashkive në zbatimin e ligjeve relevante të informimit 50
Figura 20: Raportimet e Koordinatorëve të informimit rreth nevojave për trajnime 50
Figura 21:Vështirësia e publikimit të informacionit pa kërkesë 51
Figura 22: Faktorët kyç për sukses në sigurimin e transparencës në nivel vendor 53

LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
CD	Dialog me Komunitetin
F-G	Fokus Grup
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INFOÇIP	Qendra për Çështje të Informimit Publik
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
LDI	Ligji për të Drejtën e Informimit
NjVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OSSH	One stop shop (Zyra me një ndalesë)
PBA	Programin Buxhetor Afatmesëm
PT	Program Transparence
RKP	Regjistri i kërkesave dhe i përgjigjeve
UNDP	United Nation Development Fund (Fondi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)
VKB	Vendimet e Këshilli Bashkiak

<u>Shkurtime</u>

Komisioneri	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Koordinatori i informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
Koordinatori i konsultimit	Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik
Ligji i financave vendore	Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
Ligji i informimit	Ligj Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
Ligji i konsultimit publik	Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
Ligji organik	Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

HYRJE

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të qeverisjes së mirë vendore. Në kuptimin teorik, transparenca konsiston në publikimin e informacionit procedurial dhe përmbajtësor të shërbimeve publike, në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrotjen e të dhënave personale dhe privatësinë. Pa parimin e transparencës, një qeverisje e mirë ka shumë pak kuptim. Ndërsa llogaridhënia ka të bëjë me përgjegjshmërinë e zyrtarëve publikë dhe atyre që ndikojnë këta të fundit në vendimmarrje, për veprimet e kryera në përputhje me procedurat ligjore. Ndryshe, parimi i llogaridhënies në këndvështrimin institucional njihet si "kontrollo dhe balanco" (check and balance). Të dy parimet janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me komunitetin. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", dhe Ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare.

Bashkitë, si niveli i qeverisjes më pranë qytetarëve dhe si ofrues të shërbimeve publike në nivel vendor, kanë një rol të rëndësishëm në informimin publik dhe vendimmarrjen vendore me pjesëmarrje. Për më tepër, ndërveprimi me qytetarët dhe procesi i krijimit të besimit kushtëzohen nga zbatimi i të dy parimeve - transparencës dhellogaridhënies.

Në kuadër të këtij raporti, transparenca lidhet me garantimin e aksesit të publikut në informacionin zyrtar nëpërmjet 'Programit të transparencës', sipas parashikimeve ligjore të ligjit për të drejtën e informimit në RSH. Programi i transparencës përfshin tërësinë e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik. Ndërsa, parimi i llogaridhënies apo përgjegjshmërisë sipas përcaktimeve të këtij ligji lidhet me shpjegimet dhe justifikimet e autoritetit publik për veprimet e veta tek një tjetër institucion. Në ketë kontekst, çdo strukturë e njësisë së vetëqeverisjes vendore (NJVV) duhet të përgjigjet apo të japë llogari për veprimet e veta tek autoritet e tjera (Shih figurë 1). E gjitha kjo bëhet për t'u siguruar që çdo strukturë e NjVV kryen përgjegjësitë dhe funksionet e saj me efikasitet , në mënyrë efiçente, në kohë dhe në përputhje me detyrimet ligjore për marrjen e vendimeve. Përgjegjshmëria tregon nëse respektohen parimet e ligjshmërisë, të qënit i hapur, transparencës, paanësisë dhe barazisë para ligjit.

Figura 5: Përgjegjshmëria horizontale dhe ajo vertikale në nivelin e vetëqeverisjes vendore



Puna për përgatitjen e këtij raporti është bërë e mundur në kuadër të projektit "Konsolidimi i Reformës Administrative dhe Territoriale – STAR 2", i cili zbatohet nga Qeveria Shqiptare në partneritet me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Tiranë dhe mundësohet nëpërmjet mbështetjes dhe bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, qeverive të Suedisë, Italisë, Zvicrës dhe USAID. Synimi i asistencës teknike të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) është zhvillimi i një modeli standard të programit të transparencës dhe të një sistemi të matjes së transparencës dhe llogaridhënies të përshtatur për nivelin vendor.

Në këtë kontekst, ky raport synon të ofrojë një tablo të përgjithshme të situatës ekzistuese në lidhje me zbatimin e programit model të transparencës, të identifikimit të sfidave, vështirësive dhe mundësive që ekzistojnë për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin vendor. Ndër të tjera, raporti synon të identifikojë praktikat e mira dhe faktorët kryesorë që kanë efekt shumëfishues te transparenca dhe llogaridhëna e bashkive. Gjetjet e vlerësimit do të ndihmojnë në zhvillimin e një Programi të ri model të Transparencës, të përshtatur me specifikat e NJVV-së dhe të një sistemi shoqërues të matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies.

Vlerësimi i situatës ka në fokus parimet e transparencës dhe llogaridhënies, duke synuar të ofrojë një panoramë të përgjithshme se ku qëndrojnë NJVV-të në lidhje me sigurimin e dy parimeve në nivel vendor, identifikimin e praktikave të mira, sfidave, vështirësive dhe pengesave, faktorëve dhe mundësive për sukses. Një vlerësim i tillë bën përpjekje për të adresuar pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë detyrimet ligjore të NJVV në lidhje me të drejtën e informimit?
- Si performojnë NJVV-të në zbatimin e detyrimeve ligjore?
- Si vlerësohet zbatimi i programit të transparencës nga ana e NJVV?
- Cilat janë sfidat në zbatimin e detyrimeve ligjore në lidhje me transparencën dhe informimin publik?
- Cilat janë vështirësitë dhe pengesat në nivel vendor?
- Cilët janë faktorët e suksesit dhe mundësitë për transparence në nivel vendor?

Raporti është i strukturuar si më poshtë:

Kapitulli i parë përshkruan metodologjinë e vlerësimit. Fillimisht prezantohet kuadri analitik për vlerësimin e situatës ekzistuese në lidhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor dhe qasja e rezultateve sipas fushave dhe treguesve të vlerësimit. Prezantimi i metodave kërkimore tregon burimet e grumbullimit të informacionit.

Kapitulli i dytë përmbledh gjetjet e vlerësimit të kategorizuara në dy grupe kryesore. Fillimisht ofrohen gjetjet e kuadrit ligjor në lidhje me detyrimet ligjore të NJVV si në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies në përputhje me fushat kryesore të vlerësimit të prezantuar në kuadrin analitik. Gjetjet analitike nga analiza e të dhënave sipas fushave të vlerësimit, ofrojnë një tablo të përgjithshme të situatës ekzistuese në lidhje zbatimin e programit të transparencës, kapacitetet vendore, sfidat dhe vështirësitë si dhe faktorët kyç për sigurimin e transparencës në nivelin vendor duke identifikuar edhe çështjet kryesore që kanë nevojë për vëmendje.

Kapitulli i tretë paraqet konkluzionet përfundimtare.

Kapitulli 1. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

1.1 Kuadri analitik për vlerësimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor

Vlerësimi i transparencës dhe llogaridhënies në nivelin vendor është kryer në përputhje me kuadrin analitik që prezantohet në këtë rubrikë. Kuadri analitik për vlerësimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor përfshin njëzet treguesish të grupuar në pesë fusha kryesore vlerësimi. Fushat dhe treguesit përkatës janë identifikuar bazuar në kuptueshmërinë e kuadrit ligjor në lidhje me detyrimet ligjore të NJVV për informimin publik si dhe infrastrukturën rregullatore që mundëson transparencën dhe llogaridhënien në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri.

Identifikimi i proceseve, përgjegjësive dhe dokumenteve përkatës në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi për transparencën, konsultimin dhe pjesëmarrjen qytetare është thelbësore për përcaktimin e këtij kuadri vlerësimi.

Fushat e vlerësimit dhe numri i treguesve përkatës janë si më poshtë:

1. Instrumentet e transparencës – 3 tregues
2. Kuadri rregullator dhe vendimmarrja vendore – 5 tregues
3. Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit – 7 tregues
4. Zyrtarët e lartë – një tregues
5. Strukturat për transparencë dhe llogaridhënie në nivel vendor – 4 tregues

Diagrama më poshtë paraqet fushat kryesore të vlerësimit dhe treguesit përkatës.

Figura 6: Fushat kryesore të vlerësimit dhe treguesit përkatës



Të dhënat për vlerësimin e treguesve të kuadrit analitik u siguruan nëpërmjet zbatimit të procesit të mëposhtëm:

Figura 7: Diagrama e procesit zbatues të vlerësimit

Vlerësimi i situatës aktuale

Vlerësimi i performancës së bashkive në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien		
Bashki	Metotoda kërkimore	Vlerësimi
61 bashki	kërkimi në faqet zyrtare të bashkive 49 bashki (bashki që kanë faqe interneti)	vlerësimi i treguesve sipas gjendjes reale
	kërkimi në faqet zyrtare të 29 bashkive (bashki që kanë Program transparence)	përcaktimi i niveleve të performancës

	pyetësorë i administruar elektronikisht me Koordinatorët e informimit	61 koordinatorët e informimit rreth sfidave, mundësive dhe vështirësive për zbatimin e PT

Vlerësimi i zbatimit të programit të transparencës

Bashki	Metodat kërkimore	Indikatorë
15 bashki	analiza e programit të transparencës	vlerësimi i treguesve bazuar në karakteristikat e informacionit të bërë publik pa kërkesë
	intervista me përfaqësues të ekzekutivit	6 intervista
	intervista me përfaqësues të këshillit bashkiak	6 intervista
	intervista me përfaqësues të administratës	6 intervista
	Focus grupe me përfaqësues të tre niveleve (ekzekutivit, vendimarrjes lokale dhe administratës)	3 diskutime
	Dialogë me komunitetin	3 takime me komunitetin

Raport Vlerësimi mbi situatën ekzistuese

1.2 Metodologjia e vlerësimit

Metodologjia përfshin kombinimin e shqyrtimit të dokumentacionit me metodat kërkimore cilësore dhe sasiore. Instrumentet e përdorur gjatë vlerësimit të situatës ekzistuese paraqiten si më poshtë:

1. Shqyrtimi i dokumentacionit (kuadri ligjor dhe nënligjor në nivel vendor, programet aktuale të transparencës në nivel vendor, etj);
2. Diskutime në fokus grupe me përfaqësues të tre nivele të qeverisjes lokale: përfaqësues të ekzekutivit, këshillit bashkiak dhe administratës;
3. Intervista të thelluara gjysëm të strukturuara me përfaqësues të tre nivele të qeverisjes lokale: përfaqësues të ekzekutivit, këshillit bashkiak dhe administratës;
4. Dialog me komunitetin me përfaqësues të shoqërisë civile, sektorit privat dhe medias;
5. Pyetësor i administruar elektronikisht me koordinatorët për të drejtën e informimit.

1.2.1 Shqyrtimi i Dokumentacionit

Shqyrtimi i dokumentacionit përfshiu shqyrtimin dhe analizimin e kuadrit ligjor në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien në nivel vendor si dhe të kornizës së brendshme rregullatore në nivelin e qeverisjes vendore. Shqyrtimi i detajuar i kuadrit parësor ligjor (po jo i kufizuar vetëm në këto) përfshiu ligjin e informimit[1], të konsultimit publik[2], ligjin organik[3], të financave vendore[4], dhe të kartës europiane të vetëqeverisjes vendore[5]. Identifikimi i detyrimeve ligjore të bashkive në lidhje me të drejtën e informimit dhe përcaktimi i treguesve në lidhje me dy dimensionet, transparenca dhe llogaridhënia, ka qenë edhe një ndër synimet e shqyrtimit të kuadrit ligjor.

Analiza e zbatimit të programeve të transparencës së 15 bashkive të përzgjedhura *(shih Aneks 1: Kriteret në përzgjedhjen e bashkive)* është bërë sipas treguesve të përcaktuar në kuadrin analitik të vlerësimit. 15 bashkitë përfaqësojnë një spektër të gjerë të tipologjive të bashkive (urbane/rurale, nr. popullsie, nivele performance të transparencës, vendndodhje gjeografike, popullsi minoritare etj.)[6]. Gjithashtu, analiza përmbajtësore e programeve të transparencës shërbeu për të kuptuar fushat ku bashkitë performojnë mirë në lidhje me publikimin e informacionit zyrtar, si dhe fushat problematike ku bashkitë publikojnë informacion të paplotë ose nuk publikojnë fare. Identifikimi i praktikave të mira në lidhje me publikimin e informacionit pa kërkesë gjithashtu u arrit të bëhej nga shqyrtimi i PT në bashki të ndryshme. Rregullore të brendshme funksionimit të administratës, të këshillit bashkiak, dhe të tjera dokumente që lidhen me kuadrin e brendshëm rregullator janë shqyrtuar për të kuptuar mënyrat dhe mjetet që bashkitë, si organe vetëqeverisëse, përdorin në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore në lidhje me informimin dhe konsultimin publik.

1.2.2 Diskutime në Fokus-Grupe

Diskutimi në fokus grup synon të mbledhë informacion cilësor në lidhje me zbatimin e programit të transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor, përfshirë por jo të kufizuar në sfidat, vështirësitë dhe praktikat e mira si dhe faktorët e suksesit për një transparencë dhe llogaridhënie efektive në nivel vendor. Diskutimet në F-G ishin të rëndësishme për të mbledhur të dhëna në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien në nivel vendor nga perspektiva e "ofruesve" të informacionit publik. Tre diskutime në F-G me përfaqësues të 15 bashkive të përzgjedhura (të cilat u përkasin niveleve të ndryshme të performancës në lidhje me transparencën) u zhvilluan duke grupuar bashkitë sipas vendndodhjes gjeografike *(Shih Aneks 2: Diskutimet në Fokus Grupe)*. Pjesëmarrësit u përkasin nivele të ndryshme, konkretisht: përfaqësues të ekzekutivit; përfaqësues të këshillit bashkiak; përfaqësues të administratës vendore. Pjesëmarrja mesatare në çdo diskutim varion nga 10-12 pjesëmarrës.

1 Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
2 Ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"
3 Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"
4 Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
5 Ligj Nr.8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore

1.2.3 Intervista të thelluara individuale

18 intervista individuale u zhvilluan me përfaqësues të niveleve të ndryshme të qeverisjes lokale: a) përfaqësues të ekzekutivit: kryetari/e dhe/ose nënkryetari/e; b) përfaqësues të këshillit bashkiak: kryetari/e, sekretari/e ose anëtar/e këshilli; c) përfaqësues të administratës së bashkisë: koordinatori/e për të drejtën e Informimit, ose koordinatori/e i njoftimit dhe konsultimit publik, ose drejtor/e departamenti të buxhetit, financës, prokurimeve publike etj.

1.2.4 Dialogë me komunitetin

Tre dialogë me komunitetin u organizuan me përfaqësues të OSHC-ve aktive, medias lokale, sektorit të biznesit, grupeve të ndryshme komunitare dhe qytetarë aktiv në tre bashki nga 15 bashkitë e përzgjedhura *(Shih Aneks 3. Dialogë me Komunitetin)*. Dialogët ishin të rëndësishëm për të mbledhur informacion cilësor rreth transparencës dhe llogaridhënies nga ana e "konsumatorëve" të informacionit publik. Dialogu me komunitetin synon njohjen me / dhe mbledhjen e opinioneve dhe perceptimeve të aktorëve jo-publik rreth transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore, vështirësive dhe sfidave në zbatimin e kërkesave ligjore, kanaleve të komunikimit dhe cilësisë së informacionit të bërë publik nga bashkia, rekomandimeve për përmirësime etj. Pjesëmarrja mesatare në takime është 15-20 pjesëmarrës.

1.2.5 Pyetësor i strukturuar i administruar elektronikisht

Pyetësor i strukturuar, i administruar elektronikisht nëpërmjet Google Form, synon të vlerësojë burimet njerëzore të angazhuara në pozicionin e Koordinatorëve të Informimit në 61 bashkitë e vendit, me fokus në aftësitë dhe kualifikimet e tyre si dhe identifikimin e nevojave për ndërtim të kapaciteteve për të kontribuar në sigurimin e transparencës efektive në nivel vendor. Në total, vetëm 56 bashki (92%) plotësuan pyetësorin. *(Shih Aneksin 4: Pyetësori dhe tabelat e përgjigjeve).*

Gjetjet e pyetësorit shërbejnë për të kuptuar më mirë sfidat, vështirësitë dhe mundësitë për transparencë dhe përgjegjshmëri efektive në nivel vendor. Gjithashtu, ato shërbejnë si hap i parë për zhvillimin e një programi model të transparencës përshtatur me specifikat e njësive të qeversisjes vendore dhe të një sistemi të matjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë

1.3 Qasja ndaj rezultateve

Kuadri analitik për vlerësimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor i prezantuar në rubrikën 1.2 të këtij raporti, përfshin 5 fusha kryesore të cilat përbëjnë infrastrukturën rregullatore për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies. Këto fusha përmbajnë 20 tregues në total.

Të dhënat për treguesit e secilës fushë mblidhen nëpërmjet kërkimit elektronik për të vlerësuar gjendjen e tyre reale në faqet zyrtare të bashkive sipas nivele më poshtë:

a) Treguesi gjendet i plotë;
b) Treguesi gjendet i pjesshëm;
c) Treguesi nuk gjendet.

Vetëm për dy nivelet e treguesve, a) dhe b), realizohet vlerësimi në lidhje kriteret e informacionit që përkojnë me karakteristikat e tij.

Përkufizimi i kritereve të informacionit bazohet në Urdhrin nr.14 datë 22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP, referuar si Komisioneri)[7], në të cilin tregohen karakteristikat e informacionit të bërë publik pa kërkesë. Këto karakteristika mbi informacionin e publikuar përfshijnë:: a) i plotë; b) i saktë; c) i përditësuar; d) i thjeshtë në konsultim; e) i kuptueshëm; f) lehtësisht i aksesueshëm; g) i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

Në kontekst të këtij vlerësimi, kriteret e përshtatura për informacionin e bërë publik pa kërkesë janë si më poshtë:

a) I plotë - *kur Informacioni i bërë publik përputhet me kërkesat ligjore, duke siguruar të gjithë dokumentet sipas ligjit përkatës;*
b) Lehtësisht i aksesueshëm;
c) Lehtësisht i përdorshëm;

Secili prej treguesve vlerësohet bazuar: a) së pari në gjendjen reale të tyre në faqen zyrtare të bashkive; dhe në vijim b) në kriterin e informacionit, pra për nga cilësia edhe përmbajtja e informacionit të bërë publik në lidhje me treguesin.

Figura 8: Procesi i vlerësimit të treguesve



Për secilin tregues u hartua lista e dokumenteve/informacionit relevant (sipas detyrimeve ligjore), që duhet të bëhet publik pa kërkesë, që treguesi të vlerësohet i plotë (vlerësimi është 100% të pikëve të kriterit). Kjo shënon dhe bazën fillestare të vlerësimit të kategorive të informacionit të bërë publik pa kërkesë, nga bashkitë në PT.
Për treguesit kur informacioni i bërë publik nuk është i plotë (sipas detyrimeve ligjore), pra i pjesshëm vlerësimi është bërë për 25% të pikëve.
Ndërsa, për treguesit ku nuk është vënë në dispozicion informacion publik, ose informacioni i bërë publik nuk është relevant, pra nuk përputhet me detyrimet ligjore, vlerësimi është bërë me 0 pikë.

[7] Urdhri Nr.14 Datë 22.01.2015 "Mbi miratimin e programit të transparencës", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Totali i pikëve të vlerësimit për një bashki varion nga 0-100 pikë, dhe tregon pikët finale të vlerësimit për të pesë fushat nën vlerësim. Totali prej 100 pikësh tregon rastin e një bashkie që performon shumë mirë përsa i përket informimit publik.
Rezultatet e pikëzimit ndahen në tre grupe: 1) më shumë se 70 pikë kategorizohen bashkitë me performancë të mirë në lidhje me transparencën vendore; 2) 50-70 pikë kategorizohen bashkitë me performancë mesatare; 3) më pak se 50 pikë kategorizohen bashkitë me performancë të dobët.
Në mënyrë të strukturuar procesi i pikëzimit të performancës është orientuar sipas parimeve, fushave të vlerësimit dhe treguesve të kuadrit analitik. *(Shih Aneks 5: Kuadri analitik i vlerësimit).*

Figura 9: Diagrama e vlerësimit të performancës së bashkive në lidhje me informimin publik dhe transparencën



Më poshtë paraqitet matrica e vlerësimit të një fushë specifike Transparenca dhe Llogaridhënia financiare. Ilustrimi tregon lidhjen e fushës me treguesit përkatëse dhe shpjegimin e tyre nëpërmjet kriterit të infromacionit: I plotë - (kur informacioni i bërë publik për kriterin specifik përputhet me kërkesat ligjore, duke siguruar të gjithë dokumentet sipas ligjit përkatës).

Figura 10: Ilustrimi i vlerësimit të treguesve për transparencën dhe llogaridhën në nivel vendor

Parimi	Transparenca dhe Llogaridhënia në nivel vendor	
Fusha e vlerësimit (30%)	**Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit**	**Pesha e fushës: 30%** Pikët totale: 30
Treguesit	1. Programi buxhetor afatmesëm vendor 2. Buxheti vjetor 3. Raport vjetor për zbatimin e buxhetit 4. Taksat dhe tarifat vendore 5. Raporte Auditimi 6. Pagat 7. Kontratat me të tretë	– 4 pikë – 5 pikë – 4 pikë – 5 pikë – 5 pikë – 3 pikë – 4 pikë
Kriteri	I plotë	*Informacioni i bërë publik përputhet me kërkesat ligjore, duke siguruar të gjithë dokumentet sipas ligjit përkatës.*

Treguesi	Kriteri	Referenca ligjore
(1) Programi buxhetor afatmesëm vendor	*Programi përfshinë bërjen publike të:* (i) dokumentit e parë; (ii) dokumentit të rishikuar dhe (iii) dokumentit të plotë të PBA-së, së bashku dokumentacionin shoqërues. (për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program)	Të gjithë dokumentat sipas ligjit 68/2017
(2) Buxheti vjetor	Buxheti përfshin bërjen publike të: (i) dokumentacionin bazë dhe (ii) dokumentacionin shoqërues	Të gjithë dokumentat sipas ligjit 68/2017 dhe 139/2015
(3) Raport vjetor për zbatimin e buxhetit (Zbatimi i buxhetit)	*Raportet e zbatimit të buxhetit përfshijnë:* – Raportet mujor (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës? – Tre raportet katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit; – Raportin vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor	Të gjitha të dhënat sipas nenit 44 të ligjit 68/2017
(4) Taksat dhe tarifat vendore	*Taksat përfshijnë bërjen publike të:* – Baza e taksave dhe tarifave	Të gjitha të dhënat sipas

	– Niveli i taksave dhe tarifave – Afati i pagesave – Gjobat e aplikueshme – Kamatëvonesat e aplikueshme – Përjashtimet apo ulje taksave dhe tarifave	nenit 12 të ligjit 68/2017
(5) Raporte Auditimi	Raportet përfshijnë bërjen publike të: - Raportet e auditimit të jashtëm - Raportet e audititimit të brendshëm	Të gjitha sipas ligjit 68/2017 dhe 139/2015
(6) Pagat	- Të dhëna për pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë. - Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë - strukturat e pagave për njësitë e vartësisë	Të gjitha sipas ligjit Nr. 119/2014 dhe VKM Nr. 165, datë 2.3.2016
(7) Kontratat me të tretë	- Procedurat e prokurimeve - listën e kontratave të lidhura - shumat e kontraktuara - përshkrimi i shërbimeve dhe mallrave - Palët kontraktuese - Standartet dhe cilësia e kërkuara - informacioni për zbatimin dhe monitorimin e kontratave	Të gjitha sipas ligjit Nr. 119/2014 dhe 139/2015

Pikëzimit të treguesve sipas kritereve të përshkruar më sipër për secilën bashki i shtohet edhe analiza e të dhënave cilësore të grumbulluara nëpërmjet F-G, dialogëve të komunitetit dhe intervistave individuale në lidhje me çështjet e listuara si më poshtë, të cilat plotësojnë gjithë të dhënat e grumbulluara në përgatitjen e këtij raporti:

- Hartimi dhe publikimi i programit të transparencës;
- Transparenca dhe përgjegjshmëria financiare;
- Transparenca e vendimmarjes së Këshillit të Bashkisë;
- Transparenca mbi kuadrin ligjor, politik dhe aktet e brendshme rregullatore;
- Transparenca dhe përgjegjshmëria mbi ushtrimin e funksioneve;
- Transparenca dhe përgjegjshmëria mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë;
- Transparenca në lidhje me informimin me kërkesë;
- Cilësia e informacionit të bërë publik pa kërkesë;
- Kanalet e informimit dhe komunikimi me qytetarët;
- Kapacitetet vendore dhe angazhimi për transparencë;
- Sfidat dhe mundësitë.

Të gjitha nëntemat ose çështjet sigurojnë informacion cilësor që lidhet me përvoja praktike, perceptime dhe njohuri nga perpsektiva të ndryshme, të tillë si përfaqësues të ekzekutivit, këshillit bashkiak dhe administratës lokale. Gjithashtu perceptimet e aktorëve të shoqërisë civile,

medias dhe sektorit privat janë siguruar në këtë aspekt. Kjo është bërë për të kuptuar më qartë sfidat, vështirësitë dhe mundësitë që ekzistojnë në nivelin e qeverisjes lokale si dhe elementët për sukses në lidhje me sigurimin e transparencës efektive.

1.4 Profili i të intervistuarve

Raporti i pjesëmarrësve të përfshirë në kërkim sipas sektorit dhe nivelit të përfaqësimit në njësitë e vetqeverisjes vendore tregon se përqindjen më të lartë e kanë përfaqësuesit e administratës së bashkisë (55%), dhe të shoqërisë civile (23%). Përfaqësuesit e këshillit bashkiak përfaqësohen me 11% dhe ata të nivelit ekzekutiv të bashkisë 6%. Përfaqësuesit e medias dhe biznesit përfaqësohen respektivisht me 1% dhe 3%.



Figura 11: Pjesëmarrësit e intervistuar sipas sektorëve dhe niveleve të përfaqësimit

Raporti bazuar në aspektin gjinor tregon se më shumë se gjysma e tyre (54%) janë meshkuj dhe 46% femra. Ky raport në kuadër të instrumenteve të ndryshëm të përdorur varion, mund të veçojmë se pyetësori elektronik ka patur përqindjen më të lartë të përgjigjeve nga gjinia femërore, 57%, përkundrejt 45% meshkuj; ndërkohë që intervistat individuale me përfaqësues të niveleve të ndryshme të vetëqeverisjes vendore kanë raportin më të ulët të femrave të intervistuara, vetëm 33% përkundrejt 67% të meshkujve. Dy instrumentet e tjerë, dialogët me komunitetin dhe fokus grupet, raporti i pjesëmarrësve femra dhe meshkuj është i njëjtë, dhe specifikisht 42% femra dhe 58% meshkuj.



Figura 12: Pjesëmarrësit e intervistuar sipas gjinisë

Kapitulli 2. Gjetjet

2.1 Legjislacioni mbi tranparencën dhe llogaridhënien në në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri

Ngritja dhe funksionimi i qeverisjes vendore në Shqipëri është parashikuar nga Kushtetuta e Republiksë së Shqipërisë. Neni 13 të saj përcakton se "Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore". Ndërsa kreu i gjashtë i saj (përkatësisht nenet 108-105) përcakton se bashkia është njësi bazë e qeverisjes vendore, këshilli i bashkisë është organi përfaqësues dhe kryetari është organi ekzekutiv i bashkisë. Gjithashtu në Kushtetutë është parashikuar dhe mënyra e zgjedhjes së organeve të bashkisë si dhe të drejtat dhe detyrat kushtetuese të tyre. Bazuar në këto norma kushtetuese, rregullimi në themel i qeverisjes vendore është bërë nëpërmjet ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i cili përcakton misionin, të drejtat, përgjegjësitë, kompetencat, funksionet, burimet dhe shpenzimet e vetëqeverisjes vendore. Në kapitullin IV të tij, ligji rregullon transparencën, konsultimin dhe pjesëmarrjen qytetare në nivel vendor.

Gjithashtu, transparenca dhe llogaridhënia janë trajtuar dhe rregulluar edhe nga (i) Ligji "Për të Drejtën e Informimit", i cili ngarkon organet e njësive të qeverisjes vendore si autoritete publike me detyrimin e garantimit të së drejtës së informimit si detyrim kushtetues e ligjor dhe që siguron transparencën e tyre; (ii) Ligji "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" që rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik, përcakton rregullat proceduriale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike; dhe (iii) Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i cili ka përcaktuar parime, rregulla, e procedura për financat e vetëqeverisjes vendore. Ligji i ka kushtuar një rëndësi të madhe transparencës dhe llogaridhënies financiare të organeve të njësive vendore.

Programi i transparencës (PT)[8], i cili përkufizohet si tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik[9], përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë. Në këtë kuadër në përgatitjen e PT-së, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të përcaktojnë kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe si mënyrat e bërjes publike të tij. PT kalon në disa faza kryesore të cilat janë: hartimi, miratimi, zbatimi, monitorimi dhe rishikimi i tij. *Në fazën e përgatitjes* të PT-së, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të marrin parasysh interesin më të mirë të publikut duke elaboruar në tërësi detyrimet që rrjedhin nga kuadri lligjor në fuqi. NjVV-të duhet të marrin parasysh modelin e miratuar nga Komisioneri si dhe ta zhvillojnë dhe përshtasin atë me natyrën e vetëqeverisjes vendore dhe me specifikat e bashkisë përkatëse. Me rëndësi në këtë fazë është marrja e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve nga aktorët e shoqërisë civile, media, biznesi qytetarët. Bazuar në faktin se Këshilli i Bashkisë (KB) është organi përfaqësues i bashkisë dhe PT është një dokument/ një program që rregullon në tërësi gjithë procesin e informimit të publikut nga ana e bashkisë dhe jo të një organi të veçantë të tij si, dhe në përcaktimin ligjor : "*Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin*

[8] Neni 2/5 i ligj Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
[9] Neni 15/3 i ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim[10]", *faza e miratimit* të PT i përket KB.

Ndërkohë *zbatimi i PT* është në detyrën dhe përgjegjësinë e ekzekutivit të bashkisë i cili: duhet të rregullojë dhe të drejtojë koordinimin mes strukturave/njësive të administratës së bashkisë; të caktoj koordinatorin për të drejtën e informimit; si dhe të ngrejë dhe ta bëjë funksionale gjithë infrastrukturën përkatëse për të venë në dispozicion të publikut informacionin përkatës.



Figura 133: Fazat kryesore të Programit të Transparencës në nivelin e vetëqeverisjes vendore

Monitorimi është një fazë dhe një proces mjaft i rëndësishëm i PT dhe ka dy dimensione, atë të vlerësimit dhe të mbikqyrjes nga institucionet publike dhe atë nga institucionet dhe aktorët jo-publike. Në lidhje me monitorimin nga institucionet publike rolin parësor e ka KDIMDP, i cili mbikqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vërehen mosrespektime të tyre, bën vlerësimin e kundravajtjes dhe vendos gjobat administrative përkatëse. Ndërkohë, KB është një organ tjetër publik, në këtë rast në nivelin vendor, që mbikëqyr informimin e publikut nga ana e bashkisë duke analizuar dhe vlerësuar shkallën e zbatimit të rregullave që ai vetë ka vendosur për këtë qëllim si edhe duke e kërkuar kryetarin e bashkisë në raport për këtë qëllim. Aktorët jo publik që përfshihen në monitorimin e zbatimit të PT janë organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët të cilët nëpërmjet monitorimit luajnë një rol thelbësor në përmirësimin e transparencës, llogaridhëniës dhe në krijimin e besimit qytetar.

Transparenca dhe përgjegjshmëria financiare është një fushë e rëndësishme e informacionit publik që duhet të vihet në dispozicion të publikut. Ligji për të drejtën e informimit ka përcaktuar se të dhënat për buxhetin dhe planin e shpenzimeve janë kategori e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Ligji për vetëqeverisjen vendore ka përcaktuar elementët që duhet të përmbaj buxheti për qëllime të transparencës11, nga të cilët mund të përmendim: objektivat kryesorë, rezultatet e pritshme, parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, të gjitha transfertat e kushtëzuara, të gjitha fondet e mbartura, parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse. Gjithashtu, ky ligj ka përcaktuar se para shqyrtimit dhe miratimit të buxheti KB zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme etj. Ndërkaq,

[10] Neni 18/3 i ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
[11] Neni 41 i ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

ligji për financat e vetëqeverisjes vendore ka rregulluar në detaje elementët e transparencës dhe përgjegjëshmërisë financiare që përfshijnë publikimin e akteve kryesore si: Planin Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë; Programin buxhetor afatmesëm vendor; Buxhetit vjetor; Taksat dhe tarifat vendore; dhe raportet e ndryshme (të monitorimit, auditit si dhe të realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve).

Transparenca mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë

Ligji për vetëqeverisjen vendore përcakton se bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, e cila përbëhet nga disa njësi administrative dhe këto të fundit nga qytetet dhe/ose fshatrat. Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak që zgjidhet në përputhje me kodin zgjedhor. Përbërja, krijimi, mënyra e organizimit, kompetencat dhe detyrat e këshillit bashkiak janë përcaktuar nga neni 113 i Kushtetutës dhe ligji për vetëqeverisjen vendore. Autoriteti vendimmarrës, në emër të komunitetit, është përqëndruar në këshill i cili ka kompetencën të miratojë akte normative vendore dhe politika vendore. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në përputhje me kodin zgjedhor. Kryetari i Bashkisë është i ngarkuar me funksionimin e përditshëm të bashkisë. Për ushtrimin e detyrave, kryerjen e funksioneve të vetëqeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve, në bashki ngrihet dhe funksionon administrata e bashkisë, njësitë ekonomike dhe institucionet buxhetore në varësi të saj.

Transparenca dhe përgjegjshmëria mbi ushtrimin e funksioneve dhe të administrimit të shërbimeve

NjVV ofrojnë shërbime publike, në përputhje me funksionet e caktuara me ligj, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë[12]. Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e 41 funksioneve të cilët janë grupuar në 7 fusha[13] (neni 23-29 e ligjit nr. 139/2015). NjVV sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve: 1) njësive organizative të veta; 2) ndërmarrjeve për shërbimet publike; 3) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta; 4) partneritetit publik dhe privat dhe shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të tyre. Pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, bashkia është përgjegjëse për: (i) hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit; (ii) hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës; (iii) krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor. Ligji për të drejtën e informimit ka përcaktuar se informacioni për shërbimet, që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, janë kategori e informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

[12] Neni 32/1 i ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

[13] Në fushën e (1) infrastrukturës dhe shërbimeve publike, (2) e shërbimeve sociale (3) kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, (4) mbrojtjes së mjedisit (5) bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit (6) zhvillimit ekonomik vendor dhe (7) sigurisë publike

2.2 Identifikimi i detyrimeve ligjore dhe organi përgjegjës

Aktualisht nuk ka një sistem të unifikuar dhe të standartizuar për matjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në nivel vendor, pavarësisht se janë kryer një serë studimesh që kanë qenë të fokusuar ose kanë prekur edhe matjen e transparencës, por që janë bazuar në kritere të pjesshme. Gjatë shqyrtimit të kuadrit ligjor, u pa e nevojshme listimi i të gjitha detyrimeve ligjore që rrjedhin për NJVV në kuadër të sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies.. Fokusi i analizës ligjore u kufizua në përthyerjen e LDI në nivel vendor. Pra, në ç'mënyrë përmbushen detyrimet e LDI duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor parësor të vetëqeverisjes vendore (ligji organik dhe ligji i financave vendore) si dhe ligjin e konsultimit.

Bazuar në shqyrtimine ligjeve të sipërcituara, detyrimet ligjore janë identifikuar nëpërmjet pyetjeve të cilat në vetvete krijojnë një listë kontrolli që mund të përdoret nga bashkitë dhe aktorë të tjerë për të vlerësuar përmbushjen e këtyre detyrimeve në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien. Kjo listë hedh bazat si për krijimin e një modeli të ri të PT specifik për NJQV-të, ashtu edhe për krijimin e një sistemi shoqërues matës.

Në përgatitjen e listës së kontrollit, në vemendje ka qenë edhe qartësimi i përgjegjësisë për përmbushjen e detyrimeve, me qëllim që kjo listë të shërbejë edhe si një mjet për matjen e transparencës dhe llogaridhënies qoftë asaj horizontale (administratë-ekzekutiv-këshill bashkie) ashtu edhe asaj vertikale (të zgjedhur lokal-qytetarë' qeveri lokale-qeveri qëndrore).

Figura 14: Lista e Kontrollit mbi detyrimet ligjore të vetqeversisjes vendore për transparencë dhe llogaridhënie

Nr.	***Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"***	***Referenca ligjore***	***Përgjegjësia***
1	A e publikojnë organet e vetëqeverisjes vendore çdo akt të tyre në faqen zyrtare të internetit?	Neni 15/2	KB & Kryetari
2	A publikohen aktet e këshillit në faqen zyrtare të internetit të bashkisë?	Neni 18/3	KB
3	A kanë caktuar njësitë e vetëqeverisjes vendore koordinatorin e transparencës?	Neni 15/3	Kryetari
4	A kanë miratuar njësitë e vetëqeverisjes vendore programin e transparencës?	Neni 15/3	KB & Kryetari
5	A kanë caktuar njësitë e vetëqeverisjes vendore koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik?	Neni 16/2	Kryetari
6	A është përcaktuar në rregulloren e KB mënyra se si shtetasit lejohen të ndjekin mbledhjen e KB?	Neni 17/1	KB
7	A është përcaktuar në rregulloren e KB mënyra se si bëhet këshillimi me publikun?	Neni 18/2	KB
8	A janë përcaktuar në rregulloren e KB rregullat se si bëhet informimi i publikut?	Neni 18/3	KB
9	A janë përcaktuar në rregulloren e KB mënyra dhe forma e paraqitjes së iniciativave qytetare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të tyre?	Neni 20/1	KB

10	A zhvillon këshilli bashkiak seanca këshillimi me bashkësinë përpara shqyrtimit dhe miratimit të: a) Rregullores së brendshme të funksionimit të vet? b) Buxhetit dhe ndryshimeve të tij? c) Tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave të tretëve? d) Taksave dhe tarifave vendore? e) Normave, standardeve e kritereve për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë bashkisë me ligj?	Neni 18/1 dhe 54	KB
11	Buxheti i bashkisë për qëllime të transparencës a përmban: a) Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh? b) Të gjitha transfertat e kushtëzuara, të parashikuara për t'u marrë nga qeverisja qendrore? c) Të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për t'u siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë bashkisë nga çfarëdolloj burimi? d) Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse; e) Parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja? f) Objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera?	Neni 41/2	KB & Kryetari
12	A është në dispozicion të publikut çdo raport i kontrollit të jashtëm apo auditimit të brendshëm mbi funksionimin e bashkisë?	Neni 43/3	Kryetari
13	A janë përcaktuar në rregulloren e administratës së bashkisë detyrat dhe përgjegjësitë specifike të koordinatorit të transparecës?	Neni 64/j	Kryetari
14	A janë përcaktuar në rregulloret e administratës së bashkisë detyrat dhe përgjegjësitë specifike të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik?	Neni 64/j	Kryetari

Nr	***Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"***	***Referenca ligjore***	***Përgjegjësia***
1	A është përgatitur dhe miratuar programi i transparencës nga ana e bashkisë?	Neni 4/1	Kryetari & KB
2	A janë vënë në dispozicion të publikut 16 kategoritë e informacionin pa kërkesë?	Neni 7	Kryetari & KB
2	A është krijuar dhe bërë publik regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve?	Neni 8	Kryetari
3	A përditësohet çdo 3 muaj regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve?	Neni 8/1	Kryetari

4	A publikohet në faqen e internetit regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve?	Neni 8/1	Kryetari
5	A është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit?	Neni 10/1	Kryetari
6	A janë trajtuar dhe kthyer përgjigjet kërkesave për informim brenda afateve ligjore?	Neni 15/1	Kordinatori
Nr	***Ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"***	***Referenca ligjore***	***Përgjegjësia***
1	A i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik projektdokumentat strategjike vendore dhe aktet administrative me karakter normative që parashikohen me ligje të vecanta?	Neni 1/1 dhe 4/ç	Kryetari & KB
2	A është caktuar koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik?	Neni 10	Kryetari
3	A është publikuar në programin e transparencës plani vjetore që lidhen me procesin e vendimmarrjes në kuptim të këtij ligji?	Neni 6/b	Kryetari & KB
4	A publikohet projektaktet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik?	Neni 7	Sekretari i këshillit bashkiak
5	A përmban njoftimi për fillimin e procesit të konsultimit publik: a) Arsyet për nxjerrjen e projektaktit si dhe ndikimin që ai do të ketë? b) Afatin, vendin dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre? c) Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin? d) Vendi dhe data e organizimit të takimeve publike në rastet kur një gjë e till do të bëhet?	Neni 13	Kordinatori & Sekretari i këshillit bashkiak
6	A ju jepet palëve të interesuara koha e arsyeshme (sipas afate ligjore) për të dërguar komentet dhe rekomandimet e tyre?	Neni 15	Kryetari & KB
	A trajtohet procesverbali i takimeve publike si dokument zyrtar?	Neni 6/2	Kordinatori
7	A janë publikuar raportet vjetore për transparencën dhe a përmbajnë ato informacion për: a) Numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues? b) Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara? c) Numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes?	Neni 20/1	Kordinatori

	d) Numrin e takimeve publike të organizuara?

Nr	*Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"*	*Referenca ligjore*	*Përgjegjësia*
1	A janë bërë të njohura publikisht baza e taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, çdo përjashtim apo ulje, afati i pagesave, si dhe gjobat e kamatëvonesat e aplikueshme?	neni 12/2	Kryetari
2	A është publikuar buxhetin vjetor i bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij në faqen zyrtare?	neni 41/6	Kryetari
3	A janë publikuar çdo muaj (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) raportet e përmbledhura mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës?	neni 44/4	Kryetari
4	A janë publikuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit)?	Neni 48	Nëpunësi autorizues
5	A është publikuar raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor?	Neni 51/4	Kryetari
6	A është publikuar dokumenti i parë të programit buxhetor afatmesëm?	neni 36/9	Kryetari
7	A është publikuar dokumenti i programit buxhetor afatmesëm të rishikuar?	neni 38/2	Kryetari
8	A janë organizuar seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit për programin buxhetor afatmesëm të rishikuar?	neni 38/2	Kryetari
9	A është publikuar dokumenti i plotë i programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues?	Neni 39/3	Kryetari
10	A është publikuar Plani Strategjik i Zhvillimit të bashkisë?	Neni 32	Kryetari
11	A është konsultuar Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë me komunitetin vendor dhe grupet e interesit?	Neni 32/4	Kryetari
12	A i është paraqitur komunitetit plani për vendosjen e taksave të përkohshme vendore (në të paktën, tre konsultime publike)?	Neni 13/3	Kryetari & KB
13	A janë bërë publike donacionet e përfituara nga bashkia, përfshirë emrin e donatorit, shumën dhe qëllimin e donacionit?	Neni 20/5	Kryetari
14	A janë publikuar shitja ose dhënie me qira e aseteve dhe pronave publike së bashku me kriteret që duhet të plotësohen?	Neni 19/5	Kryetari

2.3 Renditja e bashkive sipas nivele të performancës në lidhje me transparencën

Duke zbatuar kuadrin analitik të vlerësimit të transparencës dhe llogaridhënies, u realizua vlerësimi i performancës sipas treguesve të kuadrit analitik për 61 bashkitë, nga të cilat vetëm 48 kanë faqe zyrtare. Ndërsa në vlerësimin e niveleve të përformancës u përfshinë vetëm 29 bashki të cilat kanë publikuar në faqen zyrtare program transparence. Pikëzimi i treguesve gjeneroi edhe renditjen e bashkive dhe grupimin e tyre sipas niveleve të performancës. *(shih Aneks 6: Pikëzimi i bashkive sipas treguesve të vlerësimit).*

Bazuar në këtë vlerësim (29 bashki të cilat kanë publikuar në faqen zyrtare PT): 21% e bashkive kategorizohen në nivelin performancë e mirë; 59% e bashkive në nivelin performancë mesatare; dhe 21% në nivelin performancë e dobët.

Figura 15: Grupimet e bashkive sipas nivele të performancës në zbatimin e programit të transparencës



Në tabelën më poshtë paraqiten bashkitë në grupe sipas nivelit të performancës.

Figura 16:Grupimet e bashkive sipas nivele të performancës në zbatimin e programit të transparencës

Performancë e mirë	**Performancë mesatare**		**Performancë e dobët**
>70 pikë	50-70 pikë		<50 pikë
Shkodër	Skrapar	Roskovec	Kukës
Tiranë	Lezhë	Ura Vajgurore	Përmet
Korcë	Vorë	Vau Dejës	Pukë
Devoll	Durrës	Kamëz	Kurbin
Berat	Kavajë	Dropull	Gjirokastër
Krujë	Elbasan	Bulqizë	Malësi e madhe
	Vlorë	Lushnje	
	Fier	Selenicë	
	Mat		
6 bashki	17 bashki		6 bashki

2.4 Gjetjet analitike

2.4.1 Hartimi, miratimi, publikimi, zbatimi dhe monitorimi i programit të transparencës

Analiza e situatës aktuale mbi hartimin, miratimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e PT evidentoi se, përgjithësisht, bashkitë kanë marrë dhe vënë në zbatim në mënyrë formale modelin e PT të miratuar KDIMDP. Nuk u arrit të zbulohej ndonjë bashki që të ketë zhvilluar dhe përshtatur PT me misionin dhe me fushën e veprimtarisë së NjVV dhe me specifikat e bashkisë përkatëse. Kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga LID dhe të pasqyruar në tabelën përmbledhëse të modelit të PT të miratuar nga KDIMDP në tërësi, nuk janë zbërthyer ose detajuar sipas kompetencave, funksioneve dhe shërbimeve që NjVV janë përgjegjëse.

"Programi është një program tip i transparencës. Ne jemi munduar ta përshtasim me nevojat tona, edhe për faktin që ishte një praktikë e re nuk tentuam të bënim një tentativë kurajoze." – intervistë individuale, Koordinator për të drejtën e Informimit

"Është e nevojshme që institucionet e pushtetit vendor të përshatin një model të PT që përshtatet me dinamikën e punës së tyre dhe me veprimtarinë që ato kanë" – Intervistë individuale, përfaqësues i ekzekutivit të bashkisë

"Unë kam parë modelin e e tranparencës së Bashkisë së Selanikut - open halls'- për ofrimin e shërbimeve dhe po e studiojmë për ta përshtatur në bashkinë tonë"- Fokus Grup, Koordinator për të drejtën e Informimit

"Për një PT më të mirë në bashkinë tonë në kemi parë modelet e bashkive të tjera, por të gjitha janë të njëjta sipas modelit tip të miratuar nga Komisionieri" - Fokus Grup, përfaqësues i ekzekutivit të bashkisë

Bashkitë nuk i janë përmbajtur nga ana sasiore kategorive (14) të informacionit që bëhen publike pa kërkesë dhe pasqyrohen në tabelën përmbledhëse të modelit të PT. Vetëm 46.7% e bashkive të përzgjedhura i janë përmbajtur sasisë së kategorive të informacionit, ndërkohë që më shumë se gjysma e tyre, 53.3%, nuk e kanë respektuar këtë tregues. Për shembull, Bashkia Devoll ka pasqyruar në tabelën përmbledhëse të PT vetëm 12 kategori, Malësia e Madhe 8, Berati 11, Kruja 12, Roskoveci 10 etj.

Evidentohet se 33.3% e bashkive (Malësi e Madhe, Bulqizë, Krujë, Devoll, Shkodër) nuk kanë përshkruar në tabelën përmbledhëse të PT kategorinë "*informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit*" dhe po 33% nuk e kanë pasqyruar në tabelën e PT kategorinë "*Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve,* etj". Ndërkohë 13.3% e bashkive nuk kanë të pasqyruar kategorinë *"të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë …*". Një prej bashkive nuk e ka publikuar as tabelën përmbledhëse.

Asnjë nga bashkitë e përzgjedhura nuk ka shtuar kategori tjetër informacioni në tabelën përmbledhëse të PT përveç atyre të përshkruar nga modelin e miratuar nga KDIMDP.

Gjithashtu rezulton se në modelin e miratuar nga KDIMDP nuk janë përfshirë dy kategori informacioni të përcakturara nga neni 7 i ligjit[14]. Ato janë "f) *çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik; g) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato*". Me të drejtë KDIMDP ketë e ka lënë në diskrecionin e autoriteteve publike në varësi të gjykimit të tyre dhe të fushës së veprimtarisë që ato kanë. Ndërkohë është me vend të citojmë se bashkitë janë përgjegjëse për disa funksione në fushën e shërbimeve sociale[15].

Evidentohet se aktorët jo publik (aktorët e shoqërisë civile, median dhe biznesit) raportojnë se nuk janë përfshirë në procesin e hartimit të PT. Ato shprehen:

"OSHC janë përfituese të të gjithë skemës së transparencës, por nuk di nëse ndonjë organizatë është pyetur për ndonjë gjë gjatë hartimit të PT"- CD, përfaqësues i një organizate rinore".

"Nuk kemi asnjë rol në hartimin e PT, nuk kemi informacion se kush e ka miratuar. Organizatat dhe biznesi duhet të kenë rol në monitorimin e PT"- CD, përfaqësues i OSHC lokale.

"PT është publikuar në faqen zyrtare, por është i pa plotë, është një copy-paste e atij që ka miratuar Komisioneri; nuk është zhvilluar sipas kontekstit vendor, nuk janë pyetur këshilltarët e bashkisë dhe shoqatat e sektorit civile"- Intervistë individuale, përfaqësues i këshillit bashkiak.

Të gjitha bashkitë e marra në analizë kanë ngritur infrastrukturën elektronike për publikimin e informacionit pa kërkesë. Ato kanë krijuar faqen zyrtare të tyre dhe në faqen e parë (home) kanë krijuar një menu mbi PT, disa e kanë të emërtuar "Transparenca" ndërkohë disa të tjerë 'Programi i Transparencës'. Nga analiza e tyre evidentohet se menuja mbi transparencën në faqen kryesore të internetit (home) është e ndërlidhur me disa nënmenu, ku njëra nga këto është PT ndërkohë nënmenutë e tjera përmbajnë informacione/dokumenta për kategori të ndryshme informacioni si p.sh. bashkia Korçë 19 nënmenu përveç asaj të PT; Devolli 14; Përmeti 8; Vora 4 etj.

Të pyetur rreth nivelit të zbatimit të programit të transparencës në bashkinë e tyre, 50% e Koordinatorëve të informimit të intervistuar shprehen se zbatimi i PT është bërë i plotë, përkundrejt 46% të tyre që e vlerësojnë zbatim të pjesshëm.

Në tabelën përmbledhëse të modelit të PT të miratuar nga KDIMDP është dhënë kolona "*Dokumenti / Përmbajta*". Në ketë kolonë bashkitë kanë vendosur dokumenta/përmbatje dhe informacione të ndryshme. Evidentohen dy praktika të ndryshme operuese në lidhje me këtë kolonë. Së pari, 33.3% e bashkive kanë vendosur ndërlidhjen e këtyre dokumentave me përmbajtjen/ informacionin e tyre me anë të linkeve, p.sh. bashkitë Shkodër, Devoll, Krujë, Bulqizë. Një mënyrë e tillë i mundëson publikut akses të shpejtë në informacion dhe është në të njëtën linjë me qasjen që përdorin KDIMDP[16] dhe Avokati i popullit[17]. Së dyti, 40% e e bashkive (Korçë, Roskovec, Kukës, Kurbin, Gjiokastër, Malësia e Madhe) nuk kanë vendosur ndërlidhje me

[14] Ligj Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 7 pika f dhe g
[15] Neni 24 i ligjit Nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore
[16] http://www.idp.al/programi-i-transparences-i-kdimdp/
[17] http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/transparenca-e-institucionit

përmbajtjen/informacionin e këtyre dokumentave. Ndërkohë, Bashkia Berat në këtë kolonë ka shënuar vetëm fjalën "në link". Një qasje tjetër ndërlidhje vërehet në 13.3% e bashkive (Elbasan dhe Përmet) të cilët e kanë vendosur ndërlidhjen me anë të linkeve tek kolona "Mënyra e publikimit". Kjo praktikë është në të njëjtën linjë me qasjen që përdorur AKSHI.[18]

Nga anketimi i Koordinatorëve në lidhje me vlerësimin e informacionit të bërë publik pa kërkesë në faqen e internetit të bashkisë, kemi gjetjet si më poshtë:

- Pjesa me e madhe e Koordinatorëve, 64%, e vlerësojnë informacionin e bërë publik pa kërkesë të plotë, përkundrej 16% të cilët e vlerësojnë të paplotë dhe 20% që shprehen neutral;
- 61% e Koordinatorëve e vlerësojnë informacionin e bërë publik pa kërkesë të përditësuar, përkundrej 18% të cilët e vlerësojnë të papërditësuar dhe 21% që shprehen neutral;

- Pjesa me e madhe e Koordinatorëve, 84%, e vlerësojnë informacionin e bërë publik pa kërkesë të kuptueshëm, përkundrej 5.4% të cilët e vlerësojnë të pakuptueshëm dhe 10.7% që shprehen neutral;
- 75% e Koordinatorëve e vlerësojnë informacionin e bërë publik pa kërkesë të aksesueshëm, përkundrej 9% të cilët e vlerësojnë të paaksesueshëm dhe 16% që shprehen neutral;

Për miratimin e PT vërehen dy praktika: a) i miratuar nga KB; b) nga Kryetari.

"Koordinatori e harton PT, kryetari bën miratimin ndërsa kabineti i kryetarit bën monitorimin" – përfaqësues I ekzekutivit, bashki rurale

"Në rastin e bashkisë sonë, Këshilli e miraton programin dhe kjo është gjë shumë pozitive duke qënë se këshilli përfaqëson grupe të ndryshme interesi" – intervistë, përfaqësues i Këshillit

"Programi është miratuar nga këshilli bashkiak. Ndërsa monitorohet nga kryetari i bashkisë me nënkryetarët të cilët munndohen të monitorojë punën e koordinatorit dhe zbatimin e programit" – intervistë, përfaqësues i ekzekutivit

"Nuk janë pyetur këshilltarët e bashkisë dhe shoqatat e shoqërisë civile për miratimin e PT"- Intervistë individuale" - përfaqësues i këshillit bashkiak

"Transparencën duhet ta ketë si kryefjalë i pari kryetari i bashkisë" – FG, përfaqësues i administratës.

Evidentohet se aktorët jo publik vendor (aktorët e shoqërisë civile, median dhe biznesit) janë përfshirë pak ose aspak në procesin e monitorimit të PT.

[18] http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/PROGRAMI_I_TRANSPARENCES__se_AKSHIt.pdf

"Duhet t'i japim rolin e duhur shoqërisë civile dhe biznesit në hartimin dhe monitorimin e PT"- Intervistë individuale, përfaqësues i këshillit bashkiak.

"Shoqërinë civile e shoh të fokusuar në monitorimin dhe propozimin e programit të transparencës"- CD, përfaqësues i një organizate lokale.

Nuk ka një praktikë të institucionalizuar të monitorimit të PT nga ana e aktorëve vendor jo publik.

"Nuk kam informacion se kush e bënë dhe si e bënë monitorimin e PT"- CD, përfaqësues i shoqërisë civile.

"Ne, si këshill, nuk kemi miratuar rregulla për monitorimin e PT"- Intervistë individuale, përfaqësues i këshillit bashkiak.

Bashkitë në faqet e tyre të internetit nuk kanë ngritur një kanal komunikimi me qytetarët (aktorët jo publik) për të tërhequr mendimet, komentet dhe rekomandimet e tyre mbi PT. Këto mendime dhe opinione qytetare mund të shërbejnë si një bazë e mirë për rishikimin herë pas here të PT.

2.4.2 Transparenca dhe Përgjegjshmëria financiare

Buxheti dhe plani i shpenzimeve përfaqësojnë një nga kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë[19]. Publikimi i kësaj kategorie informacioni do të konsiderohet i plotë në rastet kur përmban të gjithë elementët e përcaktuar në ligjin për vetëqeverisjen vendore[20].

Nga kërkimi nuk u evidentua asnjë bashki që të ketë publikuar të tre dokumentet nëpër të cilët kalon procesi i hartimit dhe i miratimit PBA, si publikimin e dokumentit të parë të PBA (neni 36/9 i ligjit[21]), publikimin e dokumentit të rishikuar (neni 38/2 i ligjit[22]) dhe publikimin e dokumentin e plotë PBA (neni 39/3 i ligjit[23]).

Informacioni i publikuar nga bashkitë për PBA përgjithësisht vlerësohet jo i plotë sepse sipas ligjit[24]:

(i) PBA përfshin informacionin për 6 vite (dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese). PBA e bashkisë Shkodër përmban informacion për 4 vite, i bashkisë Berat për 5 vite, i bashkisë Vorë për 3 vite, etj.

(ii) PBA përfshin informacionin për qëllimet, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve etj. PBA e bashkisë Shkodër ka informacion të plotë në lidhje më këtë cështje, por kjo nuk mund të thuhet për PBA-në e bashkisë Elbasan që përmban vetem një tabele apo i bashkisë Devoll që përmban disa tabela.

[19] Neni 7, Ligji "Për të Drejtën e Informimit"
[20] Neni 41 i ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
[21] Ligj Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
[22] Po aty
[23] Po aty
[24] Neni 36/4, po aty

(iii) Sasia e të dhënave/informacionit, duke marrë si tregues numrin e faqeve të publikuar, varion shumë nga një bashki në tjetrën. Për shembull, PBA e publikuar nga bashkia Shkodër përmban 697 faqe, ndërsa e Beratit 58, Korça 27 dhe Elbasani 1 faqe (një tabelë).

Praktikë e mirë: Bashkia Shkodër ka publikuar në faqen zyrtare të bashkisë dy dokumente të PBA 2017-2019 dhe 2018-2020, të cilat aksesohen lehtësisht nga kategoria e informacionit "Buxheti" në PT. Mbi bazën e klasifikimeve buxhetore dokumenti është ndarë 13 programe, ku secili është një nënmenu më vete e ndërlidhur me përmbatjen e PBA-së me anë të një linku. Në total PBA me 13 programe përmban 697 faqe, p.sh programi "Infrastruktura Rrugore" përmban 137 faqe dhe një faqe matricë; programi "Kultura dhe Shërbimet Rekreacionale" përmban 90 faqe etj. Në të 13 programet e PBA, është vendosur një tabelë me përmbajtje automatike e cila lehtëson punën lundruese të lexuesit në document. *Kjo është një praktikë e mirë në lidhje me publikimin e informacionit të plotë, lehtësisht të aksesueshëm dhe të përdorshëm. Është e këshillueshme që dokumentet me më shumë se 10 faqe të kenë tabelë përmbatje automatike.*

Rreth 86.6% e bashkive të përzgjedhura i publikojnë taksat dhe tarifat vendore duke vendosur në dispozicion të publikut vendimin përkatës të KB, por vetëm 33.3% e tyre kanë siguruar akses nëpërmjet linkeve nga PT. Informacioni mbi taksat dhe tarifat përgjithësisht është i plotë, sepse në dokument mund të gjenden të gjithë elementët e kërkuar nga ligji (llojin, bazën, nivelin, afatin e pagesave të taksave dhe tarifave etj).

Dokumentet e publikuar janë të skanuara që lejojnë shkarkimin/zbritjen e tyre por nuk ofrojnë mundësinë e përdorimit nëpërmjet përpunimit të informacionit (kopjimit).

"Si qytetar nuk më duket normale që kur kërkoj të dhëna për buxhetin më jepet një material me 800 faqe. E nuk e quaj efektive të zhbiriloj 800 faqe për të gjetur një gjë. Ka një mungesë të gjerë vëmendjeje ndaj këtij aspekti" – qytetar, Dialogë me Komunitetin, Shkodër.

Praktika të mira: Dokumenti i publikuar nga bashkia Shkodër përmban 69 faqe, nuk është i skanuar, ka tabelë me përmbatje automatike, e cila lehtëson kërkimin, lejon shkarkimin/zbritjen e tij si dhe lejon procesin e kopjimit, duke e bërë informacionin të përdorshëm. Gjithashtu bashkia ka ndërtuar në faqen e parë të internetit (home) një menu "Taksat e mia" ku çdo qytetar mund të llogarisë taksat e tij. Bashkia Berat ka publikuar një broshurë informuese mbi detyrimet tatimore vendore për tatimpaguesit familjarë, ku përmban informacion të plotë, të kuptueshëm dhe të përditësuar.[25]

Rreth 66.7% e bashkive të përzgjedhura publikojnë buxhetin vjetor, ndërsa rreth 33.3% e tyre nuk vendosin në dispozicion të publikut informacion mbi buxhetin vjetor. Në përgjegjësi, bashkitë kanë vendosur në dispozicion të publikut vendimin e KB mbi buxhetin, duke skanuar vendimin përkatës, por vërehen edhe praktika të tjera si: (i) Bashkia Korçë ka vendosur në dispozicion të publikut një dokument në formatin pdf me 147 faqe, me tabelë përmbatje, por jo automatike

[25] Ligj Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"

dhe që lejon shkarkimin e kopjimin e informacionit; (ii) Bashkia Elbasan ka publikuar një tabelë në excel, e cila nuk përmban informacion të detajuar siç kërkohet nga ligji.

Aksesin në informacionin mbi buxhetin nëpërmjet tabelës së PT e kanë mundësuar vetëm rreth 50% e bashkive që e kanë publikuar.

Nga bashkitë e përzgjedhura nuk u evidentua asnjë bashki që të ketë publikuar: (i) raportet mujore (*pas muajit prill)* të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve[26]; (ii) tre raportet katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit[27]; (iii) raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit[28]; (iv) raportin e auditimit të jashtëm[29] dhe (v) dokumentacionin shoqërues të buxhetit[30]. Pa publikimin e raporteve dhe dokumentave të sipërcituara informacioni mbi buxhetin nuk mund të konsiderohet i plotë.

Aktorët jopublikë evidentojnë se:
"Raportet e auditit nuk publikohen në faqen e bashkisë"- CD, përfaqësues i shoqërisë civile

"Raporti mujor i shpenzimeve as nuk është menduar ndonjëherë për t'u publikuar, kjo për shkak të mos leximit mirë të ligjit, neglizhencës dhe mosfunksionimi i hallkave të caktuara"- CD, përfaqësues i shoqërisë civile

"Informacioni aktual në lidhje me buxhetin në aspektin cilësor është i dobët"- CD, përfaqësues i shoqërisë civile

Ndërkohë aktorët publik evidentojnë se:
"Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit kanë vështirësi për t'u publikuar sepse mungon vullneti i titullarit dhe ka mosnjohe të kompetencave dhe detyrimeve ligjore" – FG, përfaqësues i këshillit bashkiak

"Ligji për financat vendore është një praktike e re, paraqet vështërsi për zbatim"- FG, përfaqësues i administratës

Informacion për procedurat e prokurimit

Nuk u arrit të evidentohet asnjë bashki që të ketë vendosur në dispozicion të publikut në mënyrë të plotë informacion për procedurat e prokurimit; për procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik; informacion për kontratat (listën, shumën, palët kontraktuese, përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave).

[26] Ligji nr 68/2017, neni 44/4
27 Ligji nr 68/2017, neni 48/3
28Ligji nr 68/2017, neni 51/4
[29] Ligji nr 68/2017, neni 51/3-c
[30] Ligji nr 68/2017, neni 41/6

Evidentohet se pjesa më e madhe e bashkive të përzgjedhura, 93.3%, informacionin për procedurat e prokurimit, procedurat e koncesionit/ partneritetit publik si dhe për kontratat, e përshkruajnë si kategori informacioni në PT, por 85.7% e tyre nuk kanë vendosur asnjë informacion përmbajtësor për këtë çështje në dispozicion të publikut përkundrejt 14.3% e bashkive që kanë vendosur informacion. Evidentohet vetëm një bashki (Dropulli) që nuk ka e përshkruar si kategori informacioni në PT.

Edhe në rastet kur bashkitë kanë vendosur informacion në dispozicion të publikut (rreth 14.3%), informacioni është i kufizuar vetëm në publikimin e regjistrit të parashikimit dhe atij të realizimit të prokurimeve publike dhe jo në informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave. Gjithashtu, asnjë bashki nuk ka vendosur në dispozionin të publikut informacion për kontratat shumë vjeçare, p.sh informacion për kontratat me të tretë për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake apo për mirëmbajtjen e rrugëve vendore etj.

Aktorët jo-publik evidentojnë se:
"Informacioni për kontratat nuk publikohet dhe e njëjta gjë thuhet edhe për realizimet vjetore të prokurimeve" - CD, përfaqësues i shoqërisë civile

Përfaqësuesit e bashkisë evidentojnë se:
"Problem ngelet publikimi i raporteve të auditimit, kontratave dhe prokurimet publike për shkak të vështirësisë në pasqyrim në kohë të tyre" - FG, përfaqësues i administratës

Praktikë e mirë: Bashkia Shkodër në faqen e saj të internetit ka ndërtuar aplikacionin "Transparenca e Buxhetit"[31], i cili mund të aksesohet direkt nga faqja kryesore (home) si edhe nëpërmjet tabelës përmbledhëse të PT. Nëpërmjet këtij aplikacioni bashkia realizon transparencën e buxhetit për shpenzimet e buxhetit sipas 13 programeve apo klasave të tij, për të ardhurat për çdo njësi administrative, për *taksat e mia* për çdo njësi administrative dhe për çdo lloj takse. Kjo është një praktikë e mirë e cila nga njëra anë duhet zhvilluar më tej duke u plotësuar me gjithë informacionin e duhur dhe, nga ana tjetër, duhet t'u prezantohet bashkive të tjera, të cilat mund ta marrin në konsideratë atë në raport me kapacitetet dhe mundësitë që kanë për të përmirësuar transparencën financiare.

2.4.3 Transparenca dhe përgjegjshmëria mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë

Një kategori tjetër informacioni që bëhet publike pa kërkesë është edhe përshkrimi i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Në bazë të këtij përcaktimi ligjor, publikut duhet t'i vihet në dispozicion informacion në lidhje me organet e bashkisë (KB dhe Kryetar bashkie), administratën, njësitë ekonomike dhe institucionet buxhetore në varësi të saj. Informacioni duhet të përqendrohet tek funksionet dhe detyrat e bashkisë.

[31] http://scm.smartprocesses.net/smartapps/scm/geoportal/map.aspx

Rreth 67.6% e bashkive të përzgjedhura publikojnë organigramën e bashkisë, ku elementët kryesorë të saj janë organet e bashkisë (KB, Kryetar) dhe administrata. Më shumë se gjysma e bashkive, 53.3 %, publikojnë strukturën organizative, rreth 40% strukturën e pagave, ndërkohë që informacion për institucionet në varësi publikojnë vetëm 26.7% e tyre.

Bashkitë e përzgjedhura nuk kanë siguruar akses nëpërmjet PT në lidhje me detyrat e KB,[32] ndonëse duhet theksuar se të gjitha bashkitë kanë krijuar në faqen e internetit një menu për KB në të cilën jepet informacion për përbërjen, strukturat drejtuese, rregulloren e organizimit dhe funksionimit si dhe detyrat.

Pjesa më e madhe e bashkive, rreth 87.6%, publikojnë rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të administratës, por aksesi nëpërmjet PT bëhet e mundur vetëm nga 20% e tyre.

Praktikë e mirë: Bashkia Shkodër nëpërmjet një linku në PT (dokumenti '*Rregullorja Bashkia Shkodër 2017*') i siguron publikut informacion të plotë, të saktë, të kuptueshëm dhe *lehtësisht të aksesueshëm* për detyrat e gjithë stafit të bashkisë, duke përfshirë drejtuesit e lartë, drejtoritë, njësitë administrative dhe lagjet. Dokumenti përmban 137 faqe dhe ka një tabelë përmbajtjeje automatike e cila lehtëson kërkimin në dokument nga lexuesi.

Ndër bashkitë e përzgjedhura nuk u arrit të evidentohet asnjë bashki që nëpërmjet PT të ofrojë informacion mbi funksionet e bashkisë[33], ndërkohë që vetëm 13.3 % e tyre kanë të vendosur në tabelën përmbledhëse të PT emërtesën 'Funksionet dhe detyrat e Autoritetit Publik', por edhe këto pa ndonjë informacion konkret.

Në tabelën përmbledhëse të PT, në kategorinë e informacionit 'Përshkrimi i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave' vetëm 13.3% e bashkive kanë vendosur emërtimin 'Të dhëna për funksionet, detyrat, kompetencat të funksionareve të lartë', që në fakt është kategori më vete informacioni.[34] Gjithsesi, nën këtë emërtim nuk është vendosur informacion në dispozicionin të publikut.

2.4.4 Transparenca mbi kuadrin ligjor, politik dhe vendimmarrja vendore

Kërkimi në lidhje me publikimin e informacionit mbi aktet ligjore dhe nënligjore, kodeve dhe dokumenteve politike etj., tregon se rreth 20% e bashkive të përzgjedhura në tabelën përmbledhëse të PT japin një përshkrim të përgjithshëm duke përdorur termin 'Në faqen zyrtare', pa bërë ndonjë specifikim tjetër në lidhje me këtë kategori informacioni. Kjo mënyrë publikimi nuk mundëson akses të shpejtë për publikun mbi dokumentet ligjore e politike që prekin jetën e tyre. Faqja zyrtare përbëhet nga shumë faqe dhe nënfaqe dhe për këtë arsye publikimi në këtë formë nuk ndihmon publikun të gjejë informacionin që i intereson.

32 Ligjit 139/2015, neni 54
33 Funksionet sipas neneve 23-29, Ligjit 139/2015
34 Ligjit 119/2014, neni 7/d

Më shumë se gjysma e bashkive të përzgjedhura, rreth 53.3 %, specifikojnë menunë se ku ndodhet informacioni mbi legjislacionin. Kërkimi tregon se nuk ka standartizim të menusë ku vendoset kjo kategori informacioni dhe as emërtimi për kategorinë. Shembujt konkret më poshtë tregon larminë e mënyrave në publikimin e kësaj kategorie informacioni:

1. Bashkia Shkodër në menunë “Këshilli Bashkiak”; në menunë “Për Bashkinë”; në menunë “Për Qytetarët / Planifikim dhe Zhvillim Territori”; në menunë “Për Qytetarët / Mjedisi”;
2. Bashkia Korçë në menunë "Transparenca”;
3. Bashkia Devoll në menunë “Transparenca”/ Këshilli Bashkiak;
4. Bashkia Krujë në menunë “Dokumenta”; në menunë “Komuniteti”; në menunë “Programi i Transparencës”
5. Bashkia Roskovec në menunë “Legjislacioni”. *Ky lloj specifikimi lehtëson aksesin e publikut në kategorinë e informacionti mbi legjislacionin.*
6. Bashkia Elbasan nëpërmjet një linku në kolonën “Mënyra e publikimit” mundëson aksesin në legjislacion.
7. Bashkia Bulqizë ketë gjë e mundëson nëpërmjet linkeve në kolonën “Dokumenti/ Përmbajtja” në PT.

Rreth 20 % e bashkive të përzgjedhura (p.sh. Devoll, Përmet, Vorë) kanë krijuar lidhje me faqen ‘Legjislacioni Vendor’ të platformës VENDIME.AL, e cila administrohet nga Qendra për Çështje të Informimit Publik (INFOÇIP). Informacioni mbi legjislacionin nga kjo platformë ofrohet falas dhe është i organizuar në 13 nënfaqe. Çdo nënfaqe përmban disa akte ligjore dhe nënligjore të qeverisjes vendore për një funksion të caktuar.

Ndërkohë, disa bashki të tjera, të tilla si Shkodra dhe Kruja, e kanë të organizuar informacionin mbi legjislacionin në faqen e tyre të internetit në shumë faqe dhe nënfaqe sipas strukturave apo funksioneve që ato janë përgjegjëse.

Pjesa më e madhe e bashkive të përzgjedhura, reth 93.3 %, publikojnë në faqet e tyre të internetit vendimet e KB. Vendimet janë dokumente të skanuara, aksesohen lehtësisht me 2-3 klikime si dhe dhe mund të shkarkohen/zbriten.

Përgjithësisht, evidentohet se ekziston një qasje dhe frymë e njëjtë nga bashkitë në publikimin e vendimeve, të cilat janë skanime të dokumentave origjinalë, me firmë dhe vulë të institucionit. Përjashtim nga ky rregull bën bashkia Kukës, e cila në faqen e vet publikon vetëm një listë të vendimeve të KB pa përmbajtjen e tyre. Ndërsa bashkia Elbasan ka krijuar nënfaqe ‘Vendimet e këshillit të bashkisë’, por nuk u arrit të aksesohej asnjë vendim i KB.

Megjithatë në lidhje me publikimin e vendimeve të KB, të intervistuarit kanë theksuar edhe ndikimin që ka marrëdhënia mes ekzekutivit dhe KB. Konfliktet ndërmjet tyre rezultojnë në rezistencë të administratës në publikimin e vendimeve të KB.

“Personi përgjegjës nuk i publikon vendimet në faqen zyrtare të bashkisë pa urdhër të Kryetarit, i cili nuk ka vullnet për të bërë këtë gjë” – intervistë individuale, përfaqësues i KB

Vërehet se më shumë së gjysma e bashkive të përzgjedhura, rreth 53.3 %, publikojnë informacion për vendimet e KB nëpërmjet PT përkundrejt 46.7% që nuk i ndajnë nga PT. Evidentohet përqindje e barabartë e bashkive (50%) që publikojnë vendimet e KB nëpërmjet faqes së tyre internetit dhe atyre që publikojnë nëpërmjet një linku me platformën VENDIME.AL.
Vetëm një pjesë e vogël e bashkive të përzgjedhura, 20%, vendosin në dispozicion të publikut informacion në lidhje me vendimmarjen me pjesëmarrje, ose siç njihet ndryshe këshillim me publikun.

Praktikë e mirë: Këshilli bashkisë Shkodër në rregulloren e vet të funksionimit ka përcaktuar mënyrat se si bëhet këshillimi me publikun (neni 51 i rregullores). Ndërsa, bashkia në faqen e vet zyrtare ka krijuar faqen "Këshillim me Publikun" nëpërmjet të cilës bëhen njoftimet për konsultim. Në secilin njoftim është përcaktuar vendi, data, ora, akti për konsultim si dhe informacion përmbajtësor në lidhje me aktin. Gjithashtu, pas konsultimeve është publikuar edhe proçes verbali i dëgjesës publike.

Nuk u arrit të evidentohet asnjë bashki që të ketë publikuar në PT planin vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje si dhe raportet vjetore për transparencën.

Vihet re se përgjithësisht shumë KB operojnë me rregullore të vjetra dhe të pa përditësuara me kërkesat e sotme ligjore. Shumë prej tyre nuk kanë miratuar në rregulloret e tyre rregulla për informimin e publikut, për mënyrën se si shtetasit lejohen të ndjekin mbledhjen e KB, për mënyrën se si bëhet këshillimi me publikun, për mënyrën dhe format e paraqitjes së iniciativave qytetare etj.

Në rastet e KB që kanë miratuar rregulloret e reja, ato nuk i kanë kaluar nëpërmjet një procesi konsultimi me publikun. Në shumicën e rasteve, të intervistuarit, përfshirë këtu edhe përfaqësues të këshillit bashkiak, nuk janë të qartë rreth kërkesave ligjore për rregullore të tilla, dhe përgjegjësisë në lidhje me këtë. Gjithashtu, nga të intervistuarit janë identifikuar edhe kapacitete të kufizuara të KB, nivelit të ulët të njohjes së kornizës ligjore nga ana e këshilltarëve.

"Me aq sa di, nuk ka norma për informimin, ndërkohë për konsultimin ka disa norma që janë thjesht ato që thotë ligji dhe jo të zhvilluara sipas nevojave tona" – intervistë, përfaqësues të këshillit bashkiak

"Këshilli bashkiak nuk ka asnjë rol në këshillimin me publikun. Çdo gjë bëhet nga kryetari i bashkisë, i cili nuk e pyet këshillin për një gjë të tillë"- intervistë, përfaqësues të këshillit bashkiak

"Kapacitetet e këshillit nuk janë atje ku duhet; këshilltarët vijnë nga forca të ndryshme politike të cilat kanë këndvështrimin e tyre për transparencën; kanë nivele të ndryshme arsimore dhe kanë nevojë për trajnime rreth transparencës, njohjes më të mirë të ligjit për të drejtën e informimit, financave vendore, ligjit organik, ligjin për konsultimin publik. Këshilli duhet të dijë kompetencat që ja jep ligji dhe t'i ushtrojë ato. Ushtrimi i tyre të mos varet nga vullneti i kryetarit të bashkisë" - intervistë, përfaqësues të këshillit bashkiak

Perspektivat në lidhje me këshillimin publik janë të ndryshme nga përfaqësuesit e intervistuar sipas sektorëve. Tabela paraqet perspektivat si nga përfaqësuesit e sektorit publik, ashtu dhe jo-publik.

Figura 17: Opinionet rreth këshillimit me publikun në nivelin e vetëqeverisjes vendore nga perspektiva e aktorëve jo-publik dhe publik

Përfaqësuesit jo-publik në dialogët me komunitetin	Përfaqësuesit e vetëqeverisjes vendore
• Njoftimet për konsultime bëhen vetëm një ditë përpara takimit; • Në konsultimet me publikun prezantohen vendimet që janë marrë tashmë; • Dëgjesat publike janë të keqpërdorura nga zyrtarët, në vend se të dëgjojnë, ata flasin; • Konsultimet bëhen thjesht formalisht; • Konsultimi nuk është funksional; • Konsultohet vetëm buxheti dhe paketa fiskale; • Në konsutim thirren militantë, jo grupet e interesit; • Dëgjesat publike kanë përmbajtje partiake; • Ka pasur praktika të kaluara pozitive për marrjen e mendimit të komunitetit për nevojat prioritare të tyre të cilat duhet të kthehen; • Komuniteti duhet të jetë pjesë e vendimmarrjes si një mënyrë për t'u bërë më i ndërgjegjshëm për rolin që ka; • Qytetari duhet të mësojë të kërkojë informacion dhe të dijë ku ta kërkojë.	• Në dëgjesat publike OSHC-të janë gjithnjë prezente, kemi marrëdhie të mirë dhe dialog me ta; • Na duhen qytetarë aktiv që të na japin vërejtje; • Në bashki bëjmë takime me qytetarët çdo të enjte; • Kemi zhvilluar dëgjesa publike në lidhje me planet zhvillimore, buxhetit, planit të përgjithshëm vendor dhe integrimit të mbetjeve urbane; • Jemi munduar që kur të na vijë një projektakt ta diskutojmë me qytetarët, pra jo ta bëjmë fakt të kryer; • Diskutimi me qytetarin duhet që mundësisht të bëhet një ndryshim për të mirë; • Kemi hasur shpesh në indiferentizmin e qytetarëve; • Megjithëse njoftimi është nxjerrë në televizor, publikuar në faqen e internetit e bashkisë, nuk ka patur pjesëmarrje qytetare; • Ka indiferencë nga publiku; • Ka interes për buxhetin, ndërsa për mbetjet apo për planin e përgjithshëm vendor shumë pak interes; • Për buxhetin, pjesëmarrja është masive.

2.4.5 Transparenca dhe përgjegjshmëria mbi ushtrimin e funksioneve dhe të administrimit të shërbimeve

Informacioni për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit janë një ndër kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Duke marrë në konsideratë se bashkitë përfaqësojnë nivelin e qeverisjes më pranë qytetarëve dhe ofruesit e

shërbimeve publike në nivel vendor, kjo kategori informacioni është tejet e rëndësishme jo vetëm në lidhje me parimin e transparencës por edhe të llogaridhënies.

Gjatë vlerësimit të PT në lidhje me publikimin e informacionit për shërbimet publike nuk u arrit të evidentohej bashki që të ketë krijuar njësi të posaçme në strukturën[35] e saj për prezantimin, dhe mbikëqyrjen e performancës së shërbimit. Gjithashtu, nuk u arrit të evidentohej bashki që të ketë vendosur në dispozicion të publikut informacion për cilësinë e shërbimeve që ofron.

Më pak se gjysma e bashkive të përzgjedhura, rreth 40%, japin informacion në lidhje me shërbimet, nëpërmjet publikimit 'Në faqen zyrtare'. Një mënyrë e tillë publikimi nuk i mundëson publikut akses të shpejtë në informacion, sepse faqja zyrtare përbëhet nga shumë menu dhe nënmenu.

Ndërkohë rreth 33.3 % e bashkive të përzgjedhura nuk e përshkruajnë në tabelën përmbledhëse të PT informacionin për shërbimet si kategori informacioni. Në këto PT, publiku e ka të vështirë të gjej informacionin për shërbimet publike.

Rreth 26.7 % e bashkive të përzgjedhura e specifikojnë menunë se ku ndodhet informacioni për shërbimet. Raste të tillë janë: bashkia e Korçës e ka specifikuar në menunë '*Transparenca'*; bashkia e Vorës në menunë '*Shërbimet*'; bashkia e Roskovecit në menunë '*Për bashkinë*'; dhe bashkia e Përmetit tek menu 'T*ransparenca*'. Një specifikim i tillë ndihmon publikun në kërkimin e informacionit në lidhje me shërbimet.

Një kërkim më i thelluar në këtë grup bashkish evidentohet se nëpërmjet këtyre specifikimeve aksesohet vetëm informacion në lidhje me shërbimet administrative dhe jo për shërbimet në tërësi.

Praktika të mira: Bashkia e Vorës në PT orienton publikun se ku mund të gjendet informacioni për shërbimet publike që bashkia ofron. Në PT orientimi të drejton tek menuja 'Shërbimet' ku gjenden disa nënmenu me informacionin për shërbime të ndryshme, si p.sh, shërbimet sociale, arsimin, emergjencat etj. Bashkia e Elbasanit ka krijuar një link që krijon akses të shpejtë në informacionin për shërbimet, por edhe në këtë rast informacioni që ofrohet kufizohet vetëm tek shërbimet administrative.

2.4.6 Transparenca në informimin publik me kërkesë

Kërkesa për informim:

Numri i kërkesave për informim që marrin bashkitë në një vit varion nga 0 deri në 563 sipas raportimeve të Koordinatorëve. Më shumë se gjysma e koordinatorëve të anketuar, 52%, raportojnë se bashkitë e tyre marrin 0-50 kërkesa në vit; 14% e tyre raportojnë 51-100 kërkesa;

[35] Përshkrimi i strukturës organizative është kategori e informacionit që bëhet publik pa kërkesë (neni 7/a i ligjit nr. 119/2014)

13% raportojnë për 101-150 kërkesa dhe 20% e tyre 151-500. Më shumë se 500 kërkesa në vit është raportuar vetëm nga 2% e koordinatorëve.

Mënyrat për dërgimin e kërkesave për informim: 32% e Koordinatorëve të informimit raportojnë se mënyra më e përdorur e dërgimit të kërkesave për informim është posta elektronike 30% raportojnë postën, 21% kërkesat e kaluara dorazi, 14% raportojnë të dy alternativat – postë dhe postë elektronike, dhe vetëm 1 prej Koordinatorëve raporton nëpërmjet numrit të telefonit të vendosur në faqen zyrtare të bashkisë.

Evidentohet se pjesa më e madhe e bashkive të përzgjedhura, rreth 93.3%, e përshkruajnë kërkesën për informacion si kategori informacioni në PT, ku përjashtim bën bashkia Berat që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Nga bashkitë që e përshkruajnë si kategori informacioni, rreth 78.6% prej tyre kanë vendosur në dispozicion të publikut informacionin për procedurat për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike si dhe procedurat e ankimimit. Informacion i vendosur nga bashkitë është i plotë, i kuptueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm, ndërkohë 20% prej tyre (bashkitë e Kurbinit, Gjirokastrës, Malësisë e Madhe) megjithëse e përshkruajnë si kategori informacioni nuk vendosin asnjë lloj informacioni të dobishëm për publikun. Rreth 18.2% e bashkive që përshkruajnë këtë kategori informacioni në PT kanë krijuar një lidhje me nënfaqen Komisionerit[36] 'për individë/e drejta për informim' duke u ofruar në këtë mënyrë qytetarëve informacion të plotë, të kuptueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm.

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve: Rreth 86.7% e bashkive të përzgjedhura u evidentuan se kanë krijuar dhe publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, përkundrejt 13.3% që nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Nga analiza që e regjistrave të publikuar dhe të plotësuar u evidentua se 61.5% e tyre ishin sipas standardit të miratuar nga Komisioneri[37] duke përfshirë 6 rubrikat: (1) numri rendor (2) data e regjistrimit të kërkesës (3) objekti, (4) data e kthimit të përgjigjes, (5) statusi i kërkesës (6) tarifa.

Në pjesën më të madhe të regjistrave evidentohet se përmbajnë përmbledhje të kërkesës si dhe përmbledhje të përgjigjes. Informacioni i publikuar nga bashkitë nëpërmjet regjistrave vlerësohet i plotë, i saktë, i përditësuar, i kuptueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm. Ndërkohë rreth 23% e regjistrave nuk janë sipas standartit të miratuar nga Komisioneri. Mund të sjellim rastin e regjistrit të bashkisë Dropull[38] që përmban 7 rubrika (ka të shtuar rubrikën "nr. i prot.") dhe ai i Krujës[39] përmban 4 rubrika.
Evidentohet se regjistrat e bashkisë Vorë[40] dhe Devoll[41] nuk përmbajnë vetëm kërkesat për informacion por ato përfshijnë gjithë kërkesat për shërbime. Në këto regjistra përshkruhen kërkesa të tilla si: cënim i tokës bujqësore; kërkesë për pastrim kanali; kërkesë për caktim kufijsh të pronës private; vërtetim burgu; dërgim dok në ZVRPP; leje ndërtimi; shqyrtim problemi etj.

[36] http://www.idp.al/per-individin/
[37] Urdhër nr 14, datë 22/01/2015 Mbi miratimin e programit model të transparencës
[38] http://bashkiadropull.com/wp-content/uploads/2017/03/Libri-i-posacme-i-kerkesave1.pdf
[39] [39] http://kruja.gov.al/wp-content/uploads/2016/05/REGJISTRI-I-KERKESAVE-2017.pdf
[40] https://files.acrobat.com/a/previeë/03f233f4-7151-4b8d-b5fb-173cb528d15f
[41] http://bashkiadevoll.al/wp-content/uploads/2018/01/REGJISTRI-I-K%C3%8BRKESAVE-ANKESAVE-DHE-P%C3%8BRGJIGJEVE-VITI-2017-2.pdf

Evidentohet se regjistri i publikuar nga bashkia Kukës[42] ka në përmbajtje të dhëna që ligji i ndalon siç është identiteti i kerkuesit.

Ndërsa Koordinatorët e anketuar raportojnë se informacionet që kërkohem më shumë nga publiku renditen si më poshtë:

- Informacion për shërbimet e raportuar nga 77% e Koordinatorëve të anketuar;
- Informacion për buxhetin, e raportuar nga 11% e Koordinatorëve të anketuar;
- Informacion për paketën fiskale, e raportuar nga 7% e Koordinatorëve të anketuar;
- Informacione të llojeve të ndryshme, 5% e Koordinatorëve e kanë raportuar këtë kategori.

Informimi dhe komunikimi me banorët

Çështja e informimit të banorëve merr rëndësi të veçantë në lidhje me garantimin e transparencës mbi veprimtarinë e tyre ndaj publikut, veçanërisht ndaj grupeve të cënueshme të popullsisë të tillë si të varfrit, banorët e zonave të largëta, të papunët, grupet pakicë etj. Informimi është i rëndësishëm edhe në kontekst të reformave në të cilat kanë kaluar NJVV-të viteve të fundit.

"Reforma territoriale e ka larguar qytetarin nga qeverisja, sidomos distanca fizike për bashkinë Kukës. Ndaj, janë shumë pozitive programe të tilla që krijojnë një platformë informimi dhe komunikimi me qytetarin bazuar në legjislacionin aktual (i referohet PT)"– përfaqësues i shoqërisë civile, Dialogë me Komunitetin, Kukës.

Nga kërkimi nuk u evidentua bashki që të kishte miratuar rregulla të brendshme për informimin e këtyre grupeve. Edhe pse ka përpjekje e praktika pozitive, mund të thuhet se ende bashkitë nuk kanë zhvilluar dhe vendosur kanale të përshtatshme informimi dhe komunikimi me grupet e cënueshme.

Disa gjetje jepen si më poshtë:

- Përgjithësisht, bashkitë përdorin një sërë mjetesh informimi, të cilat sa janë të përgjithshme (përdoren nga pothuajse shumica e bashkive), aq edhe specifike për bashki të veçanta;
- Këndet e njoftimit publik raportohen pothuajse nga shumica e bashkive ngjashëm si rrjetet sociale dhe faqja zyrtare e bashkive; Këto janë mjetet që janë raportuar nga më shumë se gjysma e Koordinatorëve të Informimit (59% për dy të parat, dhe 54% për faqen zyrtare të bashkive) si mjete që përdoren më shpesh;
- Bashkitë e mëdha dhe kryesisht urbane përdorin më shumë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale, pra informacionin bazuar në teknologjinë e informacionit, por edhe TV lokale;
- Bashkitë e vogla dhe rurale përdorin në masë të madhe këndet e njoftimit, kryetarët e fshatrave dhe administratorët e njësive administrative;

[42] http://www.kukesi.gov.al/bashkia/permbajtia/uploads/2016/10/Regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-Lidhja-Nr.1.pdf

- Bashkitë të cilat kanë në funksion zyrat me një ndalesë, përdorin këtë zyrë (OSSH) për informimin e banorëve.

"...përdoren stendat (rreth 5-6 në bashki dhe nga 2 në çdo njësi administrative), të cilat përditësohen vazhdimisht. Në fshatrat e largët komunikimi realizohet nëpërmjet kryepleqve" - Intervistë, përfaqësues i ekzekutivit, bashki rurale

"Zyrat me një ndalesë janë pikë fokale e shpërndarjes dhe e marrjes së informacionit. Bashkia ka 18 njësi administrative, 12 ish komuna e 6 njësi urbane. Çdo njësi ka zyrë One stop shop (OSSH-zyrë me një ndalesë), çdo zyrë ka 3-4 punonjës që punojnë me dy turne. Ne po tentojmë të bëjmë pikën tonë të komunikimit me qytetarët. OSSH-të duhet t'i lehtësojnë jetën qytetarit, ato ndjekin procedurën e aplikimeve, kërkesave për informacion" – intervistë individuale, përfaqësues i ekzekutivit, bashki urbane

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të bashkive në lidhje me informimin e banorëve identifikohen edhe disa pengesa:

- Ekziston mendimi te qytetarët se informimi bëhet vetëm në zyrat e bashkive. Modernizimi i informimit publik nëpërmjet OSSH-ve ka nevojë për më shumë edukim, informim dhe ndërgjegjësim te banorët;

"Banorët vijnë në bashki, ende nuk shkojnë në OSSH, duhet pak punë në edukimin e qytetarëve për të kuptuar se edhe te OSSH ofrohet informimi" - intervistë individuale, përfaqësues i ekzekutivit, bashki urbane

- Mjetet e informimit duhet të përputhen me specifikat e komunitetit, të nivelit të zhvillimit të teknologjisë së informacionit në komunitetet vendore etj.

"Ndoshta ju nuk e dini por një pjesë e madhe e banorëve të ..... vuajnë pasjen e celularëve dhe internetit. Ky fakt na tregon se duhet t'jua ofrojmë informacionin qytetarëve kryesisht më shumë fizikisht sesa me internet" - intervistë individuale, përfaqësues i ekzekutivit, bashki urbane

- Disa bashki kanë mundur të zhvillojnë mjete specifike informimi me qytetarët të cilat shënojnë praktika të mira që kanë edhe efekt shumëfishues në bashki të tjera të vendit. Këtu përmendim, gazetën lokale Almanac të bashkisë Elbasan dhe bashkëpunimi i Këshillit Bashkiak Shkodër dhe medias lokale.

"...përdorim gazetën lokale të bashkisë – Almanac, e cila del çdo dy javë dhe pasqyron të gjitha zhvillimet e qytetit (investimet, të ardhurat, risitë) po ashtu edhe drejtimet e reja ku mund të fokusohet politika dhe vendimmarrja" – intervistë individuale, përfaqësues i administratës

"Që nga momenti kur jam zgjedhur kryetar këshilli, kam kërkuar nga disa media lokale që të transmetojnë mbledhjet e këshillit live. Në këtë mënyrë e gjithë bashkia e merr vesh se çfarë po bëhet në këshillin bashkiak. Pas pak muajsh që kemi filluar punën si këshill, kemi bërë dhe rregulloren e funksionimit të këshillit" – intervistë individuale, përfaqësues i Këshillit Bashkiak

2.4.7 Kapacitetet vendore për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor

Profili i Koordinatorëve për të drejtën e informimit

Të dhënat e ofruara më poshtë ofrojnë një profil të plotë të punonjësve të angazhuar në pozicionin e Koordinatorëve të informimit, përsa i përket angazhimit të tyre në këtë pozicion, përvojës me qeverisjen lokale, kualifikimet, njohuritë dhe aftësitë për përmbushjen e detyrës së ngarkuar.

Gjinia dhe mosha e koordinatorëve të informimit: më shumë se gjysma e Koordinatorëve, 57%, janë femra, ndërsa mosha varion nga 23 deri në 63 vjeç. Gjysma e Koordinatorëve, 50%, janë nën moshën 30 vjeç. Çereku i tyre, 25%, i përkasin grup moshës 30-40 vjeç dhe 20% grup moshës 41-50 vjeç. Vetëm 5% e tyre janë mbi moshën 50 vjeç.

Vite pune në pozicionin e koordinatorit të informimit: 39% e Koordinatorëve kanë 1 deri në 2 vite të angazhuar në këtë pozicion; përkundrejt 25% të cilat raportojnë se kanë 1 vit që punojnë si Koordinatorë. 21% e tyre punojnë si Koordinator për pak kohë, nga 1 muaj deri në 10 muaj; ndërsa 14% e tyre punojnë në këtë pozicion që prej 30-36 muajsh.
Përvoja me qeverisjen vendore: Në lidhje me eksperiencën e Koordinatorëve me qeverisjen lokale, më shumë se treçereku i tyre, 73%, kanë më pak se 5 vite pune në sektor, përkundrejt 4% që shënojnë më shumë se 20 vite punë; 14% raportojnë të kenë 6-10 vite, ndërsa 9% 11-20 vite.

Funksioni parësor përkundrejt dytësor: 95% e Koordinatorëve raportojnë se janë të angazhuar edhe në detyrë tjetër, përkundrejt 5% që janë të angazhuar vetëm në këtë pozicion. Pjesa më e madhe e tyre, 82% raportojnë se detyra e Koordinatorit është funksion dytësor i punës së tyre, përkundrejt 14% që e kanë funksion parësor.

Departamentet e dedikuara për informimin publik: Pjesa më e madhe e Koordinatorëve, 39%, janë drejtor/ përgjegjës/specialit në drejtoritë e informimit dhe marrëdhënieve me publikun; 34% janë të angazhuar në drejtori të ndryshme të bashkisë që merrem me IT, koordinim zhvillimin etj. 13% e koordinatorëve janë të zyrtarë të lartë të bashkive (nënkryetar, drejtor kabineti, sekretar i përgjithshëm); Vetëm 9% e tyre punojnë në zyrën e protokoll arkivës, dhe 5% punojnë me burimet njerëzore.

Arsyet e emërimit në pozicionin e Koordinatorit të informimit për 43% e tyre lidhet me faktin se funksioni parësor i punës ka lidhje funksionale me detyrën e Koordinatorit; ndërsa 41% e tyre tregon se arsyeja është te aftësitë e veçanta që ata kanë dhe që ndihmojnë në detyrën e Koordinatorit. Kualifikimi arsimor raportohet si arsye për emërimin e 11% të Koordinatorë. Ndërsa arsye të tjera të raportuara janë edhe vendim i titullarit. Gjatë intervistave u theksua se fakti që ky pozicion nuk mund të parashikohet më vete për shkak të kufizimit të numrit të parashikuar të punonjësve në strukturë.

Njohja e Koordinatorëve nga qytetarët – 50% e koordinatorëve raportojnë se qytetarët e dinë se ka një Koordinator informimi, ndërsa 14% e tyre shprehen negativisht rreth njohjes nga publiku. 36% e tyre shprehen të pasigurt për këtë gjë.

Njohja e Koordinatorëve nga qytetarët – 50% e koordinatorëve raportojnë se qytetarët e dinë se ka një Koordinator informimi, ndërsa 14% e tyre shprehen negativisht rreth njohjes nga publiku. 36% e tyre shprehen të pasigurt për këtë gjë.

Kualifikimet, njohuritë dhe aftësitë e Koordinatorëve të Informimit

Kualifikimet: 36% e Koordinatorëve raportojnë se janë trajnuar për pozicionin që mbajnë disa herë; 34% vetëm 1 herë, 28% e tyre asnjëherë, ndërsa 2% kanë marrë pjesë në konferenca organizuar nga zyra e Komisionerit.

Njohuritë dhe aftësitë e Koordinatorëve për zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit: Koordinatorët e Informimit vlerësojnë se kanë njohuri shumë të mjaftueshme për LDI në masën 44.6% përkundrejt 35.7% që vlerësojnë shumë të mjaftueshme aftësitë për zbatimin e LDI, ndërsa 45% e tyre vlerësojnë mjaftueshëm aftësitë për zbatimin e LDI, 39% vlerësojnë mjaftueshëm njohuritë mbi Ligjin.

Figura 18: Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të Koordinatorëve për zbatimin e LDI



Njohuritë dhe aftësitë e bashkive për zbatimin e kuadrit ligjor

Koordinatorët vlerësojnë se bashkitë kanë njohuri dhe aftësi më të mira në lidhje me zbatimin e Ligjit Organik (45% raportojnë mirë dhe po kaq 45% shumë mirë njohuritë dhe aftësitë e bashkisë); Ligjin për të drejtën e informimit (41% raportojnë shumë mirë, dhe 39% mirë rreth aftësive dhe njohuritë e bashkisë për LDI); Ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik (41% raportojnë mirë dhe 29% shumë mirë) dhe në fund fare vlerësojnë njohuritë dhe aftësitë për zbatimin e ligjit të financave vendore.

Grafiku më poshtë ilustron raportimet e Koordinatorëve në lidhje me njohuritë dhe aftësitë e bashkive për zbatimin e kuadrit ligjor:

Figura 19:Vlerësimi i nivelit të njohurive dhe aftësitë e bashkive në zbatimin e ligjeve relevante të informimit



Nevoja për ndërtimin e kapaciteteve

Koordinatorët e informimit vlerësojnë se kanë nevojë për trajnime kryesisht në çështjet që jepen sipas renditjes së mëposhtme (shih figurën 8):

- Bashkërendimi i punës me njësitë e tjera organizative ((titullarë, departamente, drejtori, zyra, nëpunës etj.) për zbatimin e LDI – 47% e tyre e raportojnë shumë të nevojshme trajnimin në këtë temë dhe 25% të nevojshme;
- Procedurat administrative – 37.5% e raportojnë shumë të nevojshme dhe 32% të nevojshme trajnimin në këtë temë;
- Përdorimi i mjeteve të informimit dhe komunikimit me qytetarët – 34% e vlerësojnë shumë të nevojshëm dhe 36% të nevojshëm trajnimin në këtë temë;
- Transparenca dhe llogaridhënia në nivel vendor (njohuri të përgjithshme) vlerësohet shumë i nevojshëm nga 36% e Koordinatorëve ndërsa e nevojshme nga 29% e tyre;
- Regjistrimi, trajtimi dhe dhënia e përgjigjeve të kërkesave për informacion e cila vlerësohet si shumë e nevojshme nga 39% e Koordinatorëve, ndërsa 20% e nevojshme;
- Krijimi, mbajtja, publikimi dhe përditësimi i RKP përfaqëson temën e renditur në fund për nga nevoja që kanë Koordinatorët e cila është raportuar shumë e nevojshme nga 34% e tyre, ndërsa e nevojshme 16% e kanë vlerësuar të nevojshme, përkundrejt 23% të Koordinatorëve që janë shprehur neutral.

Figura 20: Raportimet e Koordinatorëve të informimit rreth nevojave për trajnime

Shkalla e vlerësimit	Transparenca dhe llogaridhënia në nivel vendor (njohuri të përgjithshme)	Bashkërendimi i punës me njësitë e tjera organizative për zbatimin e LDI	Regjistrimi, trajtimi dhe dhënia e përgjigjeve të kërkesave për informacion	Krijimi, mbajtja, publikimi dhe përditësimi i RKP	Procedurat administrative	Përdorimi i mjeteve të informimit dhe komunikimit me qytetarët
shumë e panevojshme	3.6	7.1	16.1	16.1	1.8	12.5
e panevojshme	16.1	8.9	7.1	10.7	8.9	10.7
mesatarisht	16.1	14.3	17.9	23.2	19.6	7.1
e nevojshme	28.6	25.0	19.6	16.1	32.1	35.7
shumë e nevojshme	35.7	44.6	39.3	33.9	37.5	33.9
Totali	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

2.4.8 Sfidat dhe vështirësitë për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor

Vështirësia në garantimin e informimit publik ndërmjet dy kategorive të informacionit, pa dhe me kërkesë: Koordinatorët e informimit raportojnë se publikimi i informacioneve të dy kategorive kanë të njëjtin nivel vështirësie: 36% e koordinatorëve vlerësojnë publikimin e kategorive të informacionit pa kërkesë aspak të vështirë, përkundrejt 34% që raportojnë për informacionin me kërkesë.

Vështirësia e publikimit të informacionit publik pa kërkesë në faqen zyrtare të internetit të bashkisë

Publikimi i informacionit zyrtar në zbatim të LDI konsiderohet praktikë e re nga 32% e Koordinatorëve; ndërsa 21% e tyre vlerësojnë si arsye faktin që ato përmbajnë informacion sensitiv, 18% raportojnë si vështirësi mungesën e ofrimit të informacionit përkatës nga zyrat e bashkisë. 5% e tyre raporton se publikimi i informacionit nuk përbën prioritet të bashkisë.

Figura 21:Vështirësia e publikimit të informacionit pa kërkesë



23% e tyre kanë ofruar opsionin 'Tjetër' ku më shpesh raportohet mungesa/formatimi/përditësimi i faqes zyrtare bashkisë. Gjithashtu, një vështirësi që shprehet është edhe problemi në ngritjen e një sistemi të plotë dhe efikas komunikimi dhe bashkërendimi ndërmjet departamenteve.

"Rregullorja e funksionimit të administratës ka problem sepse është akoma e vjetra. Ajo nuk ka të përcaktuar rolin e koordinatorit dhe të drejtën të kërkojë informacion" – intervistë individuale, Koordinator për të drejtën e Informimit

"Nëse ka vullnet, bashkia mund të krijojë infrastrukturën dhe cakton personelin për të bërë transparencën e institucionit. Për momentin thjesht nuk ka dëshirë" – përfaqësues OSHC, dialogë me komunitetin, Kukës

Sfidat për zbatimin e të drejtës së informimit nga Koordinatorët e Informimit

Gjatë takimeve të fokus grupit dhe intervistave janë identifikuar disa sfida dhe vështirësi të përbashkëta për bashkitë e përzgjedhura në lidhje me zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga zbatimi i të drejtës për informin. Ato lidhen me mungesë të njohurive mbi LDI nga ana e administratës, komunikimit jo-efektiv ndërmjet departamenteve në bashki, kapacitete të ulëta në menaxhimin e dokumentacionit, praktikë e re, nevoja për ndryshim mendësie nga ana e administratës, etj.

"Të drejtën për informim dhe të drejtën për të informuar duhet ta njohë gjithë stafi i bashkisë, zyra e financës, protokollit, kadastrës. Koordinatori i informimit nuk duhet të shkojë dhe t'u lutet që zyrat përkatëse të japin informacion, por ata ta kenë të qartë që e kanë të detyrueshme dhënien e informacionit" – intervistë individuale, Koordinator i Informimit

"...nuk është se të gjithë punonjësit e administratës janë të ndërgjegjësuar mbi çka kërkon ligji përveç rasteve kur parashikon ndëshkime në disa nene dhe ligji i menaxhimit financiar dhe kontrollit. Intervistë individuale". Intervistë individuale, Drejtor i Përgjithshëm

"Vështirësitë do t'i përmblidhja në: vullnetin e titullarëve; dijenisë së titullarëve; kapaciteteve të administratës; mungesës së financave dhe llojshmërisë së instrumenteve të komunikimit" – Fokus grup, Gjirokastër

"Mungesë stafi, mungesë trajnimesh për transparencën. Njerëzit nuk janë të informuar" - intervistë, përfaqësues i ekzekutivit të bashkisë

Pavarësisht se 11% e Koordinatorëve të Informimit raportojnë se nuk kanë vështirësi përsa i përket informimit, ata rendisin disa prej sfidave me të cilat përballen gjatë ushtrimit të kësaj detyre:

- Komunikimi joefektiv me drejtoritë e tjera në bashki është raportuar nga 36% e Koordinatorëve;
- Njohuri të pamjaftueshme rreth kërkesave ligjore është raportuar nga 30% e tyre;

- Aftësi të pamjaftueshme në lidhje me përgatitjen e materialeve raportuar nga 7% e tyre;
- Vështirësi fizike (zyra, faqe zyrtare në ndërtim, në pritje të shërbimeve të zyrave me një ndalesë) është raportuar nga 5% e Koordinatorëve;
- Mungesë orientimi nga struktura drejtuese eprore e raportuar si vështirësi nga 4% e tyre;
- Praktikë e re dhe koha e pamjaftueshme për Koordinatorët (që kanë dy funksione) është raportuar nga % e barabartë e Koordinatorëve (2%).

2.4.9 Faktorët kyç për sukses në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor

Koordinimi institucional dedikuar informimit dhe transparencës është vlerësuar si faktor kyç për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies efektive në nivelin e qeverisjes vendore nga 70% e Koordinatorëve të anketuar. Ky faktor merr rëndësi të madhe në kuadër të transparencës duke patur parasysh edhe sfidat kryesore të identifikuara nëpër takimet dhe intervistat me përfaqësues të NJVV, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Koordinatorit dhe departamenteve të ndryshme të bashkisë.

Të tjerë faktorë të vlerësuar nga Koordinatorët e Informimit që janë konsideruar të rëndësishëm për sigurimin e transparencës janë burimet njerëzore të kualifikuara të raportuara nga 55% e tyre; infrastruktura fizike (IT, software) e vlerësuar nga më shumë se gjysma e Koordinatorëve të anketuar; qytetarë dhe grupe interesi aktivë janëraportuar nga 48% e Koordinatorëve etj.

Figura 22: Faktorët kyç për sukses në sigurimin e transparencës në nivel vendor



Kapitulli 3. KONKLUZIONE

Në bazë të vlerësimeve dhe gjetjeve mbi situatën aktuale, sfidat, vështirësitë dhe mundësitë për një transparencë dhe llogaridhënie efektive në njësitë bazë të qeverisjes vendore u arrit në konkluzionet e mëposhtme:

1) Shqipëria ka një paketë të mirë ligjore e cila mundëson transparencën dhe llogaridhënien efektive në nivel vendor. Paketa ligjore[43] garanton të drejtën për informim, së pari nëpërmjet rregullave e procedurave të përgjithshme për informim, pjesëmarrje në vendimmarrje, transparencë dhe llogaridhënie dhe, së dyti nëpërmjet pushtetit diskrecional (të lirisë së veprimit) që iu jep njësive të vetëqeverisjes vendore për të miratuar rregulla për transparencën dhe llogaridhënien sipas specifikave të tyre.

2) Kuadri i brendshëm rregullator vendor nuk i përgjigjet nevojave dhe detyrimeve ligjore në fuqi. Shumë KB operojnë me rregullore të vjetra dhe të pa përditësuara me parashikimet e reja ligjore. KB nuk kanë miratuar në rregulloret e tyre dispozita për informimin e publikut, për mënyrën se si shtetasit lejohen të ndjekin mbledhjen e KB, për mënyrën se si bëhet këshillimi me publikun, për mënyrën dhe format e paraqitjes së iniciativave qytetare etj. KB që kanë miratuar rregulloret e reja nuk i kanë kaluar ato nëpërmjet një procesi konsultimi me publikun.

3) Modeli i PT i miratuar nga Komisioneri dhe i vënë në zbatim nga bashkitë, është i pazhvilluar në kontekstin vendor dhe i pa përshtatur me misionin, fushën e veprimtarisë, kompetencat dhe funksionet e tyre.

4) Miratimi i PT është bërë me anë të një akti të thjeshtë formal nga kryetari i bashkisë (në shumicën e rasteve) ose nga KB pa një diskutim gjithëpërfshirës me "konsumatorët e tij" - qytetarët, aktorët e shoqërisë civile dhe të biznesit. Në aktin e miratimit nuk përcaktohet qartë se cili është procesi i hartimit dhe miratimit të PT, roli dhe përgjegjegjësia e hartuesit, miratuesit, zbatuesit dhe monitoruesit të zbatimit të PT.

5) Aksesi në informacion nëpërmjet tabelave përmbledhëse të PT është i pa unifikuar. Bashkitë përdorin qasje të ndryshme (me dhe pa linke; me dhe pa detaje shpjeguese se ku gjendet informacioni).

6) Nuk ka një sistem për matjen e transparencës dhe të llogaridhënies nga ana e bashkisë dhe aktorëve jo-publikë. Nismat e deri më sotme kanë qenë të kufizuara në vlerësimin dhe monitorimin e një apo disa kategorive informacioni në kuadrin e transparencës. Produktet e këtyre nismave janë të dobishme për ndërtimin e një sistemi të ri matjeje.

[43] Paketa përbëhet nga Ligji nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore; Ligji nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit; Ligji nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik; Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"

7) Bashkitë kanë krijuar dhe përdorin faqet e internetit për të vendosuar në dispozicion të publikut një shumëllojshmëri informacioni. Bashkitë shfaqen me kapacitete të kufizuara (sidomos bashkitë e vogla) për unifikimin dhe standardizimin e informacionit kryesisht në lidhje me sasinë, cilësinë dhe aksesin.

8) Bashkitë nuk kanë arritur të garantojnë informimin e qytetarëve në zonat e largëta dhe shtresave e grupeve në nevojë (të varfërve, të papunëve, të përsonave me aftësi të kufizuar, të vetëpunësuarve në ekonomitë dhe në fermat familjare si dhe grupeve pakicë). Bashkitë nuk kanë miratuar rregulla të brendshme për informimin e këtyre grupeve si dhe nuk kanë gjetur dhe vendosur kanale të përshtashme informimi dhe komunikimi me to.

9) Transparenca dhe përgjegjshmëria financiare është akoma larg kërkesave dhe normave të përcaktuara nga ligji për financat e vetëqeverisjes vendore. Akoma nuk bëhen publike të dhënat për zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e buxhetit. Të dhënat e publikuara për prokurimet dhe kontratat janë të cunguara. Bashkitë shfaqin mungesë vullneti dhe kapacitete të limituara për përmbushjen e transparencës dhe llogaridhënies në këtë fushë.

10) Niveli i zbatueshmërisë së ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik është shumë i ulët. Në nivel vendor, mungojnë procedurat dhe rregullat e brendshme për konsultimin publik, nuk është caktuar koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik, nuk publikohen planet vjetore për vendimarrjen me pjesëmarrje si dhe raportet vjetore për transparencën. Shqipëria nuk ka një indeks të pjesëmarrjes qytetare për të vlerësuar gjendjen e demokracisë vendore.

11) Në dispozicion të publikut nuk ka informacion të thjeshtë dhe të kuptueshëm në lidhje me përgjegjësitë, funksionet, instrumentet, sasinë, llojin, standardet dhe cilësinë e shërbimeve që bashkia ofron. Bashkitë nuk kanë krijuar në strukturën[44] e tyre njësinë e posaçme për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimeve. Bashkitë performojnë më mirë në informacionin për shërbimet administrative.

12) Bashkitë performojnë mirë në komponentin e informacionit me kërkesë. Ato kanë vënë në dispozicion të publikut informacion në lidhje procedurat për të bërë një kërkesë dhe procedurat për ankimim, adresën postare dhe elektronike. Në disa bashki ka nevojë për ndërhyrje për standardizimin e regjistrit të kërkesave për informim, shmangien e publikimit të gjeneraliteteve të kërkuesit. Gjithashtu, është i nevojshëm edhe miratimi i normave në rregulloret e brendshme të bashkisë për detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit për të drejtën e informimit, detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave dhe departamenteve të bashkisë në fushën e informimit me kërkesë si dhe për koordinimin dhe bashkëveprimin mes zyrave.

[44] Përshkrimi i strukturës organizative është kategori e informacionit që bëhet publik pa kërkesë (neni 7/a i ligjit nr. 119/2014)

13) Bashkitë nuk publikojnë të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë. Në dispozicion të publikut nuk ka të dhëna se kush janë zyrtarët e bashkisë përkatëse që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të dhënat për to, siç përcaktohen në nenin 7/d të ligjit 119/2014.

14) Faktorët kyç për sigurimin e transparencës konsiderohen: koordinimi institucional, burimet e kualifikuara njerëzore, infrastruktrura elektronike, qytetarët aktivë dhe grupet interesit si dhe vullneti i kryetarit të bashkisë.

15) Koordinatorët për të drejtën e informimit shfaqin nevojën për përmirësim të kapaciteteve, kryesisht në rritjen e njohurive rreth kornizës ligjore dhe përmirësimin e aftësive në fushën e bashkërendimit të punës me njësitë e tjera organizative të bashkisë (titullarë, departamente, drejtori, zyra, nëpunës etj.), përdorimit të mjeteve të informimit dhe komunikimit me qytetarët, regjistrimit, trajtimit dhe dhënien e përgjigjeve të kërkesave për informacion si dhe procedurave përkatëse administrative.

ANEKSE

Aneks 1: Kriteret në përzgjedhjen e bashkive

Në përmbushje të kërkesave të ToRs dhe në përputhje me propozimin e IDM-së, në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese mbi situatën aktuale, sfidat dhe mundësitë për transparencë dhe llogaridhënie efektive në nivelin e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, janë identifikuar 15 bashki të cilat u përfshinë në kërkimin cilësor.
Ky dokument synon të përshkruajë procesin përzgjedhës të 15 bashkive të përfshira në kërkimin cilësor (nëpërmjet diskutimeve në fokus-grup, intervistave të thelluara dhe dialogë me komunitetin).
Parimi kryesor që udhëhoqi procesin e përzgjedhjes së bashkive është parimi i performancës në transparencë dhe llogaridhënie. Bashkitë e përzgjedhura i përkasin tre niveleve të performancës: performancë e mirë – 5 bashki; performancë mesatare- 5 bashki; performancë e dobët – 5 bashki.

Të tjera parime u përdorën në mënyrë që bashkitë e përzgjedhura të përfaqësonin një spektër të gjerë të bashkive të vendit tonë. Parimet e tjera të përdorura janë si më poshtë:

Parimet	
1. Parimi i performancës në transparencë dhe llogaridhënie	bashkitë e përzgjedhura përfaqësojnë nivele të ndryshme të performancës në zbatimin e programit të transparencës
2. Parimi i përfaqësimit gjeografik	bashkitë e përzgjedhura përfaqësojnë vendndodhje të ndryshme gjeografike të vendit
3. Parimi i përfaqësimit politik	bashkitë e përzgjedhura përfaqësojnë spektër të ndryshëm politik
4. Tipologji të ndryshme zhvillimi	bashkitë e përzgjedhura përfaqësojnë tipologji mikse, urbane dhe rurale
5. Parimi i përfaqësimit etnik	bashkitë e përzgjedhura përfaqësojnë bashki me grupe minoritare

Për ndarjen në grupe të bashkive sipas nivele të performancës u përdor sistemi i mëposhtëm i pikëzimit, i cili u praktikua realisht në vlerësimin e treguesve të përfshirë në Kuadrin Analitik.

Pikët për secilin nivel performance janë si më poshtë:

Nivelet e performancës	**Pikët e vlerësimit**	**# i bashkive**
Performancë e mirë	>70 pikë	6 bashki
Performancë mesatare	50-70 pikë	17 bashki
Performancë e dobët	<50 pikë	6 bashki
		29 bashki

Në tabelën më poshtë paraqiten tre grupet e bashkive sipas nivele të performancës.

Performancë e mirë	Performancë mesatare		Performancë e dobët
